

Adrian Lesenciu është poet, prozator dhe eseist rumun. Ka lindur (1975) në Câmpulung Moldovenesc. Është profesor universitar, gjithashtu është kryetar i filialit Brașov të Unionit të Shkrimtarëve të Rumunisë. Ka botuar një numër të madh vëllimesh me poezi, studime si dhe romane. Është nderuar me çmime kombëtare dhe ndërkombëtare. Është një pasardhës i kompozitorit Ciprin Porumbescu - autor i muzikës së himnit tonë kombëtar.

## ADRIAN LESENCIU

Romani im “Balada” i bazuar në jetën e kompozitorit të himnit shqiptar, Cipirian Porumbescu

Bisedoi: *Andreas Dushi*



IN MEMORIAM

**Mynever Shuteriqi**  
- Fico u shua  
Nga *Feride Papeleka*

(fq. 6)

Një projekt letrar - shembull aktivizimi i rinisë në kohën e proceseve globalizuese kulturore dhe politike

(fq. 7)

Dr. shk. *Tatjana Buda Haxhimihali*

### SHËNIME MBI LIBRAT

ORFEU SHQIPTAR  
DHE KËNGA SHQIPE E  
DASHURISË

Nga *Agim Vinca*

(fq. 8)

Vëllimi poetik “Idioma”, Botimet Dukagjini

Dëshmia poetike  
e Kujtim Shalës

Nga *Adil Olluri*

(fq. 10)

“Dritarja e Marin Shkrelit” nga Ndue Ukaj  
Rrëfimi i së shkuarës që  
shërben si shërim

Nga *Anila Mullahi*


(fq. 11)

Poezia “Realiteti”, e poetes polake  
Wisława Szymborska

Realiteti “i çmendur” nën  
optikën shimborskiane

Nga *Noel Boci*

(fq. 23)



(fq. 4)

Fjala e mbajtur në mbrëmjen përkujtimore kushtuar Artistit të Merituar Fatmir Haxhiu dhe promovimit të monografisë.

**Fatmir Haxhiu**  
- Piktori i historisë

Nga *Gazmend Leka*

Mbrëmja e sotme shenjohe për dy nga figurat më të rëndësishme të artit shqiptar, piktorin Fatmir Haxhiu dhe studiuesen Suzana Varvarica Kuka. Njëri me veprën në ngjyrë e tjetra me veprën në fjalë. Libri monografik “Fatmir Haxhiu-Piktori i historisë” është një simbiozë e këtyre dy shpirtave të bukur!

Duke dëgjuar albumin  
“The Balkan Piano” –  
volumi i parë i pianistit  
AMIR XHAKOVIQ

Prof. *Zef Çoba*

(fq. 12)

122-vjetori i lindjes së nobelistit

TË NDJEKËSH ATË MAGJISTAR  
PLAK BISHTNUES:  
KUJTIME NGA BIRI I  
ISAAC BASHEVIS SINGER

Nga *Richard Eder*

(fq. 22)



### BIBLIOTEKË

Sali Bashota (fq. 10)

*Çka bëni ju atje të dielën*

Arben Meksi (fq. 14)

*Karikatura e së shtunës*

Alban Tufa (fq. 15)

*Më ndjeni për mungesën e etikës!*

Xhevair Lleshi (fq. 16)

*Dy tregime*

Ervin Nezha (fq. 17)

*Mos e prek fluturën*

Mark Simoni (fq. 18)

*Lufta*

Deborah Levy (fq. 19)

*Udha e Qumështit*

Përktheu: *Miranda Enesi*

Billy Collins (fq. 20)

*Dashuri e paqëllimshme*

Përktheu: *Roland Gjoza*

MBAHET 60-VJETORI I MITINGUT  
TË POEZISË NË GJAKOVË

(fq. 10)

Eqrem Basha, Lulzim Tafa dhe Timo  
Flloko – fitues të Çmimit “Azem Shkrelit”

(fq. 13)

**Adrian, së fundmi është botuar në gjuhën shqipe romani juaj “Balada” kushtuar kompozitorit të himnit tonë kombëtar, Cipirian Porumbescu. Çfarë ju tërhoqi te historia e tij që vendosët ta përdorni si lëndë për romanin tuaj?**

Kishte shumë çka nuk mund të më linte indiferent dhe më e rëndësishmja ndër to ishte kompozimi vetë, *Baladë për Piano dhe Violinë, op.29*, kompozim të cilin e ndjeja në vena. Ka diçka në këtë muzikë që i përket rajonit nga ku ata janë, Bucovina-s si dhe diçka që duket të jetë gjenetikisht e trashëguar. Goxha vonë dhe aksidentalisht, zbulova se vija nga familja e kompozitorit dhe ka të ngjarë që kjo të më ketë shtyrë drejt shkrimit të romanit. Teksa mbledhja të dhëna, zbulova se çfarë personaliteti i madh kishte qenë i ati i Cipirian Porumbescu-ut dhe vendosa të shkruaja rreth tij. Nëse ishin shkruar tanimë disa libra rreth Cipirianit, Irakliu që kontribuoi në ringritjen e shpirtit rumun gjatë revolucionit të 1848 në qytetin Chernivtsi, kish mbetur thujtë i panjohur. Pas botimit të romanit *Balada*, i përkushtova atij një studim tërësorë që e botova në Shtëpinë Botuese të Patriarkanës Rumune “Basilica”, pasi Irakliu pat qenë një prift ortodoks. Për t’u rikthyer te romani, kam mbledhur informacione për diku dhjetë vjet dhe nuk kam mundur të shkruaj asgjë. Gjatë pandemisë, teksha isha në karantinë, fillova të shkruaja dhe nga 15 marsi i 2020, deri më 15 prill të atij viti, e përfundova. Për mua, ishte si një çlirim.

**Nisur nga ndikimi i historisë së familjes te vetë Porumbescu, sa ndikim mendoni se ka familja te formësimi i individit?**

Ngjarjet e rëndësishme të kombit rumun kanë mbetur në mendjet dhe veprat e familjeve të studiuesve, priftërinjve dhe shkrimtarëve. Ideali i Bashkimit të Provincave Rumune – kjo është ajo çfarë rumunët kremtojnë në Ditën Kombëtare – është transmetuar kështu: idetë janë artikuluar kohë më parë dhe janë çuar para si një detyrë familjare nga fëmijët, nipërit e kështu me radhë, nga njerëz që mund t’i qaseshin edukimit dhe kështu, mund të “ndriçonin” mendjet e të tjerëve. Ishin ato kohë, sidomos në gjysmën e dytë të shekullit XIX, kur ideali politik dhe ai estetik ishin ndërthurur në kredon e familjes dhe kur disa familje kishin marrë përsipër të caktonin mbajtësin e pishtarit të këtyre ideve. Familja Porumbescu ishte njëra syresh. Irakliut dhe Cipirianit, ashtu sikurse shumë personaliteteve të tjera të ardhur nga kjo familje, përfshirë Nina Cioncan dhe Stanca Scholz-Cionca u jemi borxhli për mbajtjen e këtij pishtari dhe kalimin e tij nga njëri brez te tjetri.

**Shqipëria dhe Rumania, përgjatë historisë, kanë pasur lidhje të përhershme, kryesisht kulturore.**

# ADRIAN LESENCIUC

## Romani im “Balada” i bazuar në jetën e kompozitorit të himnit shqiptar, Cipirian Porumbescu

*Bisedoi: Andreas Dushi*

**E shihni shkrimin dhe përkthimin e këtij romani si vijimësi të kësaj tradite?**

Iluminimi i kombit rumun nuk ka ndodhur në një mënyrë që t’i ketë interesuar vetëm popullsisë me origjinë rumune. Shqiptarët nga provincat rumune kanë marrë pjesë në të njëjtën lëvizje emancipuese dhe kanë shijuar rezultate të ngjashme, bashkë me rumunët. Ka qenë një simbiozë e bukur dhe jo një garë, pasi nuk janë garat ato që zgjidhin problemet e historisë, por vetëm bashkëpunimi, bashkimi, mirëkuptimi dhe respekti i tjetrit; hapja ndërkulturore. Rumania dhe Shqipëria kanë një marrëveshje dialogu dhe respekti të ndërsjellë bazuar në këto ndërveprime kulturore, të cilat u intensifikuan në gjysmën e dytë të shekullit XIX dhe kulmuan me ngjarje historike të fillimit të

shekullit të XX. (Nënvizoj këtu një rastësi të historisë: Dita Kombëtare e Shqipërisë, 28 Nëntori, është e njëjta me ditën e rajonit nga ku unë, ashtu sikurse Cipirian Porumbescu, vijmë). Jam i lumtur të shoh se kjo marrëdhënie çohet para. Është e qartë se përkthimi i romanit *Balada* në gjuhën shqipe vazhdon këtë traditë të marrëdhënieve të mira, edhe nëse vetëm sa rikrijon atmosferën e atyre kohërave. Romani fokusohet në ideale kombëtare politike të cilat nuk janë në garë me ideale të tjera, por të cilat transmetohen nga njëri komb te tjetri. Muzika e Cipirian Porumbescut është një mjet i tillë transmetimi kulturor dhe jam i lumtur të, nëpërmjet Asdrenit, një nga kompozimet e periudhës kur Porumbescu ishte student në Vienë, është bërë himni kombëtar i Shqipërisë. Fakti që romani i bazuar në jetën e kompozitorit të himnit shqiptar rikthehet në Shqipëri



nëpërmjet përkthimit të Spiru Fuchi dhe Altin Kasos dhe botohet nga “Onufri” nuk do të thotë asgjë tjetër përveç se një mbyllje e ciklit. Cikli është vazhdimësi e traditës së shkëmbimeve kulturore në këtë marrëdhënie të bukur mes dy kombeve.

**Pse keni zgjedhur vetën e parë për rrëfimin e historisë të “Balada”?**

Historia e viteve të shqetësuara gjatë të cilëve Irakli dhe Cipirian Porumbescu kanë jetuar është rindërtuar në tekste në vetën e tretë pa mundësinë për të rikrijuar, mbështetur në dokumente historike, të vërteta të lidhura me mënyrën e të jetuarit. Duke dashur që të kuptohej se sa ngjites mund të jetë iluminimi i një kombi si dhe për t’ia dalë të riprodhoja intensitetin e përvojave personale, ishin të domosdoshëm dëshmitarë të asaj kohe. Kështu krijova historinë në vetën e parë, duke i dhënë zë atit Irakli, gërshtuar me Cipirianin dhe mandej, zëra dëshmitarësh të tjerë, përfshirë atë të poetit tonë kombëtar Mihai Eminescu, udhëtimi i të cilit në historinë tonë letrare përsëritet disi, në një intensitet tjetër si dhe me një tjetër forcë shprehjeje, të cilën Irakliu dhe Cipiriani e kanë bërë më para. Ndoshta fakti më i rëndësishëm është ai se vetëdija trans-historike në vetvete mund të shprehet në këtë mënyrë në Epilog, duke tejçuar emocionet dhe intensitetin e të jetuarit në ato kohë.

**Në krijimtarinë tuaj të gjerë, çfarë peshe ka romani “Balada”?**

Patjetër që *Balada* ka një rol domethënës në raport me veten dhe si një reflektim në vetvete përmes kësaj vetëdijeje trans-historike. Lidhur me këtë roman, ka po ashtu diçka tjetër. Më së pari, do të doja të shkruaja një roman, jo një biografi të romanizuar, kështu që nuk kam bërë asnjë lëshim në përdorimin e mjeteve artistike. *Balada* është një roman i veçantë, krejt ndryshe nga gjithë çfarë kam shkruar më para apo jam duke shkruar më pas. Është një roman historik, po ashtu bildungsroman i cili ka qëndruar shumë gjatë tek unë dhe tani duhej botuar. Po ashtu, shkrimi i tij ka qenë një formë çlirimi. Ishte shprehja natyrore e pasqyrimin të asaj që i përkiste botës më përpara. Duke zënë vendin e saj në botë, romani *Balada* u bë bestselleri im. Ishte një befasi e plotë për mua, pasi mendoja se i isha përkushtuar një mënyre të arkitekturës së të shkruarit, teknikave narrative dhe temave të lidhura me çështjen e shfaqur te *Balada*. E vetmja lidhje e tij me romanet e tjera ndodh qartësisht për hir të urisë që kam për historinë dhe për eksplorimin e hapësirave kulturore, reale a të trilluara. Prandaj, duke e ditur ekzaktësisht se ku qëndron romani në raport me të tjerët, i kam ulur pritshmëritë pavarësisht përkthimit të librit, pasi mendoja se kisha shkruar një libër thellësisht rumun. Doli se në fakt, një libër që

ishte thellësisht rumun, ishte po aq thellësisht evropian.

**Për t'u kthyer sërish te historia, tanimë në një plan më të gjerë: Sa ndikim ka historia te ju? Qoftë një histori personale, qoftë historia e vetë kombit rumun?**

Fatmirësisht, nuk kam ambicie ta rindërtoj kujtesën time personale si ditar apo memuar. Nuk mund të rri indiferent teksa zbres nga pavetëdija kolektive në magmën e historisë së hapësirave të ndryshme kulturore. Ndjej nevojë të jap histori vendesh të vërtetë a të imagjinuar, nga e shkuara ose nga zhvillime të përkohshme paralele (dhe, shpresoj, të mos bëhen asnjëherë histori e vërtetë), pasi jam autor i disa distopive. Shpesh, ngjarjet që ndodhin në romane subjektivisht rindërtojnë histori. Raportet e mia me historinë janë më shumë se intime. Duke dhënë histori vendesh të ndryshme, jap një lloj përfshirjeje subjektive të njeriut në histori dhe një lloj reflektimi, po ashtu subjektiv, të historisë në mendjen e atij njeriu. Personazhet janë instrumente përmes të cilëve historia realizohet plotësisht dhe personazhet e mi janë kryesisht personazhe dëshmitarë. Shpesh, historia heroike është rezultat e disa formave të frustrimit ose rezultat i ngjarjeve që një mbret apo sundimtar ia dikton skribëve të vet që shkruajnë kronikat. Kam zgjedhur të shkruaj libra që shkrijnë historinë në pamjen vështrimin subjektiv të karaktereve, që e bëjnë atë më njerëzore dhe që i transformojnë këto personazhe me qëllime demokratike dhe humane, në personazhe-dëshmitarë që mund të konsiderohen si "paqebërës" në histori.

**Përtej "Baladës", cili libër juaj mendoni se do t'ju paraqiste sa më mirë në gjuhën shqipe? Kështu ngacmojmë edhe kureshtjen e lexuesit shqiptar dhe nxisim botimin e tij.**

Mendoj se mund të jenë dy dyer dialogu me lexuesin shqiptar. Më së pari do të ishte romani im i fundit i titulluar *Gjuha e Krishtit* (Corint, 2024) i cili është një roman historik që rikrijon ngjarjen e komunitetit të fundit të botë, Maaloula në Siri, ku flitej akoma gjuha e Jezu Krishtit, Armaikishtja Perëndimore. Komuniteti në vitin 2013 sulmohet nga organizata terroriste e frontit Al-Nusra dhe zhduket. *Gjuha e Krishtit* ka dy personazhe kryesore. Shën Thecla është një ndër themeluesit e këtij komuniteti dhe bëhet dëshmitar i shekullit të parë të krishterimit dhe botës pa paqe dhe të pasigurt të Lindjes së Mesme në ato kohë. Personazhi tjetër, i vendosur në një tjetër shtresë të romanit është një arab i krishterë nga Libani Perëndimor i cili përfundon duke ecur në rrugën e tij të Damaskut për pendesë. Ndoshta duke u lexuar në Shqipëri, romani do t'i ofrojë lexuesit konfigurimin e gjurmëve të otomanizmit, prezentë akoma në



Lindjen e Mesme, në Rumani dhe në Shqipëri, duke shpjeguar një mënyrë të caktuar sjelljeje. Lexuesi shqiptar ndoshta do ta gjej veten në shtëpi në një libër rreth një tjetër botë që nuk është e tija, por e cila po ashtu i përket edhe atij, edhe nëse ai nuk e di se nga e di këtë.

Romani i dytë që hipotetizohet do t'i propozojë lexuesit shqiptar është *Varreza e Herojve* (Creator, 2018), i përkthyer tanimë në frëngjisht dhe gati për t'u përkthyer në greqisht, tejet i mirëpritur dhe vlerësuar. Ky roman rindërton një botë imagjinare, një shtet të quajtur Bheristan të vendosur në Lindjen e Mesme ku

praktikat diktatoriale ringjallin ato komuniste ose sjelljet e lidhura me një mënyrë të caktuar poshtërimit dhe fshirjes së historisë apo besimit dhe ku vlerat mund të gjenden lehtësisht si të asimiluara dhe përvetësuara nga lexuesi shqiptar.

**Libri juaj në shqip erdhi falë dëshirës dhe mbështetjes së ALAR. E shihni të rëndësishme për komunikimin ndërkulturor praninë e kësaj organizate dhe të tjerave si ajo?**

Ky rol është fundamental. Asgjë nuk mund të bëhet pa mbështetjen e disa organizatave, institucioneve apo

lidhjeve që luajnë rolin e thjeshtësimit të ndërmjetësimit. Roli i ALAR-it, të cilin e falënderoj për këtë mbështetje, dhe i institucioneve të ngjashme është për ta mbajtur gjallë dialogun, për ta forcuar atë, për ta thjeshtëzuar dhe për të na lejuar të shohim atë çfarë kemi të përbashkët, jo atë çfarë na ndan. Ose, thënë shkurt, kjo është ajo çfarë komunikimi ndërkulturor synon: të shihet humanja si te vetja, edhe te tjetri dhe të ndërtohen dialogë.

**Ju e njihni letërsinë shqipe nëpërmjet Ismail Kadaresë, Visar Zhitit e të tjerë shkrimtarëve që i keni lexuar dhe për të cilët keni shkruar. Si do ta përshkruanit atë në Rumani dhe përvojën e leximit të këtyre shkrimtarëve nga ju vetë?**

Kam raport të veçantë me hapësirën kulturore shqiptare. Ka shumë gjëra të përbashkët me kulturën tonë, përfshirë gjurmë të njëjta historike dhe modele sjelljesh gjysëm-identike. Unë përfshihem shumë në leximet që bëj, e megjithëkëtë, është shumë e vështirë t'i shpjegosh publikut rumun atë çfarë është në thelb letërsia shqipe. Ka ama një mënyrë jashtëzakonisht shumë të thjeshtë për ta bërë këtë: Nëse publiku dëshiron libra ku gjen përmasën estetike të shkruar nga autorë me vlerë të cilët dinë si ta përdorin përvojën personale dhe atë kolektive për t'i transformuar në letërsi, Shqipëria mund të ofrojë letërsi të cilësisë më të lartë. Mendoj se përtej aspekteve që më tërheqin mua, përmasa estetike e veprës së shkrimtarëve shqiptarë që kam lexuar është fundamentale.

**Dhe për ta mbyllur, njeriu a duhet t'i besojë më shumë historisë apo letërsisë? Jo si burim të dhënash, por si shteg nëpër të cilin duhet kaluar për ta njohur, zbuluar dhe jetuar në plotësinë e saj vetë jetën?**

Ka mënyra të shumta për të shkuar drejt dijes, sikurse është shkenca, filozofia, feja apo letërsia. Secili prej këtyre shtigjeve ka ligjet e tija dhe ofron një pamje të caktuar në horizontin e pritjes të atij që do të dijë. Për mua, letërsia është e domosdoshme, sepse ofron mundësi t'i qasesh një lloji dijeje më të thellë njerëzore. Edhe nëse filozofia tash së voni ka lëvizur nga qëllimi për t'i shpërblyer njeriut sikurse një herë e një kohë në Greqinë antike; edhe nëse shkenca ka filluar të migrojë drejt të vërtetave statistike; edhe nëse feja e interpretuar në mënyrë radikale në vend që të bashkojë, ndan dhe kontribuon në promovimin e disa ideologjive të caktuara, shtegu më pranë njerëzores për të arritur drejt dijes mbetet letërsia. Fatkeqësisht, "moda" të ndryshme letrare, ideologji të ndryshme letrare dhe kulturore e kanë kufizuar ngushtuar dijen. Besoj se letërsia e madhe e njerëzimit është shtegu më i shkurtër drejt vetes dhe feja është ajo çka lidh njerëzoren me hyjnoren. Format e tjera të dijes forcojnë tërësinë e qenies sonë.

## ADRIAN LESENCIUC

### Balada



Një roman biografik për kompozitorin e madh rumun **CIPRIAN PORUMBESCU**  
– Kompozitori i himnit tonë kombëtar –

Onufri



Monografi e studiueses Zana Varvarica Kuka

## “FATMIR HAXHIU - PIKTORI I HISTORISË”

Nga Gazmend Leka

Mbrëmja e sotme shenjohe për dy nga figurat më të rëndësishme të artit shqiptar, piktorin Fatmir Haxhiu dhe studiuesen Suzana Varvarica Kuka. Njëri me veprën në ngjyrë e tjetra me veprën në fjalë. Libri monografik “Fatmir Haxhiu-Piktori i historisë” është një simbiozë e këtyre dy shpirtave të bukur!

Vite më parë, kur bëra ekspozitën “NATURA MORTA”, pikturova maskat prej allçie të personaliteteve që kanë lënë gjurmë në jetën e njerëzve, në mbarë globin. Bëra maskën e Leninit, të Washingtonit, Napoleonit, Dantes, Beethovenit, Bruneleskit, Niçes dhe të Turnerit.

Një vit të tërë, u bëra shoqëri. I shoqërova në çastin e fundit, kur kalonin sinorin e shkonin përtej. Ishte ai çast kur trupi ftohet e kur e ngrohta kthehet në mardh dimri! Ky kalim, kishte vite e vite që kishte ndodhur, por unë në studion time, po e inskenoja aktin kureshtar! Duke pikturuar, bisedoja me secilin prej tyre në heshtje. Doja të kuptoja se çfarë mendonin atë çast, kur hidhnin hapin përtej? Nuk dyshoj që ktheheshin në fillimet e tyre, aty ku strehohet dëshira e vërtetë. Unë thjeshtë supozoja përgjigjet e secilit!

Çastin e kalimit të Fatmir Haxhiut nuk e pikturova dot. Mungonte maska e tij. Mungonte dëshira e tij e fundit, e ritreguar prej meje, por nuk dyshoj se edhe ai si të gjithë personalitetet që kanë incizuar brazda të thella në memorien kolektive, iku me një pikëpyetje të madhe, me një peng, edhe pse i sigurtë për trashëgiminë që ka lënë pas. Them peng, sepse në largim e sipër, në nxitim e sipër, nuk pati kohë ta marrë përgjigjen.

Është e trishtë, por njëherësh e bukur ta mendosh se e gjithë jeta reduktohet në një pyetje plot ndrojë e pa mendjemadhësi. Është pyetje plot ankth, e struktur në memorie, apo e shkruar diku në një copë letër. Kanë frika nga harresa! Me sy të mbyllur, në momentin e fundit pyesin veten heshtur, pa zë:

-Sa gjatë do jetoj në memorien e njerëzve?

Dhe kanë të drejtë! Është legjitime, sepse e dinë që Harresa është një monstër e frikshme dhe e pangopur. Ha e nuk vjell! Në pamundësi për ta fituar përjetësinë, të gjithë duan ta shkëmbejnë atë me jetëgjatësinë në memorien e njerëzve, sikurse zgjedhja që bëri Akili në të gjallë të vet! Pranoi

të vdiste, që ta kujtonin!

Këtë pyetje fundore, “Sa gjatë do jetoj në memorien e njerëzve?”, Fatmir Haxhiu padyshim që e ka bërë, por ndryshe. E ka bërë gati retorike, pasi e ka dhënë gjithmonë vetë përgjigjen, në formën e një dëshire fundore:

- “Unë do jem i lumtur edhe sikur një vepër të më mbetet nga gjithë krijimtaria ime!”.

E rrafshoi të gjithë atë korpus gjigand, që kishte krijuar gjatë jetës së tij vetëm për hatër të një piktore. Dëshironte të ishte një piktore e vetme, edhe pse nuk e dinte se cila do që ajo *Vepër Antidot*, përballë sklerozës kolektive!

Jam më se i bindur, se sa herë tentonte të zgjidhte njërën mes tyre, nuk vendoste dot, pasi sapo tërhiqte penelin e fundit nga telajo bërtiste me klithma brenda shpirtit - “Kjo që sapo bëra është një kryevepër!” I shkon artistit ta thotë, edhe me zë të lartë. I shkon, se krijon një “gjë” që Zoti e kish lënë pa bërë.

Zana Varvarica këtë bëri me monografinë e saj për Fatmir Haxhiun. Bëri Antidotin! I shkroi atij një letër të gjatë prej 575 faqesh, ku i thotë me dashuri se do mbesë vetëm një vepër në

memorien e popullit, siç ai dëshironte. I shkruan në 575 faqe se e gjithë vepra e tij do jetë vetëm një *Vepër*, prej fillimeve e deri në mbarim, ngjeshur me qindra piktura, mijëra vizatime, skica, bocete e projekte. I shkruan, se vepra e tij do mbahet mend e do të jetë epifanike, si Proteu me shumë pamje. Ajo do të transformohet. Do ndërrojë fytyrë. Herë do na shfaqet si kompozim e herë si portret, herë si peizazh e herë si natyrë e qetë. Transformim pas transformimi, nuk do të gjejë qetësi, ashtu si shpirti i Fatmirit, e si e tillë do na mbillet thellë në memorie.

Zana, e ka shkruar bukur këtë letër, jo vetëm nga eksperiencia e gjatë, por edhe nga dëshira për t’ia kthyer borxhin profesor Fatmirit, për vizatimin e hershëm që i kishte bërë, atë që ajo e ka vendosur në hyrje të monografisë. Më pëlqen ta evidentoj këtë detaj të ndjerë, por e vërteta është se ajo i shpreh vlerësimin për atë jetën e tij në art, atë jetën paralele që nuk e ka ndarë vetëm me fëmijët e tij biologjikë, por me publikun e madh e me të gjithë ne studentet, që vite të shkuara, prisnim me kuriozitet shfaqen e pikturës së tij në ekspozitat e fund-vitit, e cila na mbushte me energji.


Është e bukur dhe prekëse ta mendosh, se ajo studentja e dikurshme në vizatimin e profesorit, sot është një personalitet i shquar në fushën e studimit. Është autorja e 15 librave studimorë mbi artistët dhe fenomenet e artit, përtej punëve të shumta dhe aktiviteteve të panumërta cilësore që ka realizuar.

Shumë vite më parë, jam shprehur, se në bibliotekën virtuale, në mendje time, kishte një mungesë shumë të madhe të monografive për artistët shqiptarë, dhe ajo asfiksi krijonte një përshtypje të mbrapshtë se në Shqipëri, artet e bukura ishin “vrime e zezë”. Sot bibliotekat tona, në raftet e tyre kanë disa libra të tillë me kualitet të admirueshëm dhe kjo në sajë të studiuesve, ku në rresht të parë bën pjesë dhe Zana Varvarica!

Për çdokënd që e do veprën e artit, është e lehtë të shkojë në galeri dhe të shijojë pikturat e Fatmir Haxhiut! Por nuk është aspak e lehtë të ulësh e të shkruash një monografi. Kjo është dhunti vetëm e disa njerëzve. Është një udhëtim i gjatë, i vështirë dhe i “rrezikshëm”.

Është i gjatë, sepse nuk bëhet për punë ditësh, por kërkon muaj të tërë dhe vite mandej, derisa vepra të piquet. Janë ditë të mbushura plot me kërkime, grumbullime, seleksionime, balancime, evidentime, takime dhe biseda të shumta me njerëzit që e kanë njohur e i kanë ndenjmur pranë personazhit që po analizon.

Është e vështirë, sepse nuk të lë të rrih ulur, siç do rrimë ne kur të na bjerë libri në dorë e që do kemi kohën e mjaftueshme për ta parë qetësisht në rehatinë tonë. I duhej të rendte pas fakteve që nuk i gjen të grumbulluara, por të shpërndara, siç është dhe jeta e një artisti prodhimtar si Fatmiri. Janë të panumërta veprat e



tij në vite. T'i mbledhësh imazhet e tyre me cilësi shumë të mire, siç e kërkon libri i Zanës, nuk është aspak e lehtë. Gjatë rrugës u pa se Vepra e tij ishte e shpërndarë sa në Galerinë Kombëtare të Arteve, në Kryeministri, në Pallatin e Brigadave, në Shtëpinë e Oficerëve e deri në shtëpitë e kulturës e të ushtrisë nëpër rrethe.

Është e dhimbshme dhe e papranueshme që disa prej tyre kanë humbur e nuk dihet se ku kanë përfunduar!

A mund të humbasë kompozimi "Tenda e Qypit"?! Një nga kompozimet më befasuese dhe mbresëlënëse që, padyshim duhet të ishte një pasuri kombëtare e vyeredhe për "fotografimin" e një çasti të papërsëritshëm, siç është figura e borizanit. Secili prej nesh, që e pa për herë të parë në ekspozitë, është befasuar. Nuk arrinim ta besonim se kishte ndodhur ky akt. Porse tani duhet të befasohemi e të mos e besojmë që kjo humbje ka ndodhur.

A mund të shkatërrohet piktura "Me shpatë në dorë", e cila për vite me radhë u mbështoll kutullaç si një qilim dosido, i hedhur në një qoshe!? Dikur qëndronte e varur në murin kryesor të mbledhjeve të qeverisë shqiptare, në Kryeministri. Kaq mjafton për t'u mbuluar me turp, kur bëhet fjalë për këto vepra që kanë bërë histori në pikturën shqiptare. Mungojnë, se janë vjedhur, janë shitur, janë shkëmbyer dhe e kanë bërë të vështirë plotësimin e koleksionit me imazhe cilësore. Zanës i është dashur që në këtë kaos të vendosë rregull dhe ia ka dalë në krye për mrekulli!

Është e rrezikshme, sepse studiuesi,

dashje pa dashje krijon një simbiozë me personazhin që merr në analizë. Personazhi në fjalë nuk është dosido, por i rëndësishëm e i zëshëm, sikurse Fatmir Haxhiu. Është personazh i mbushur me vepra dhe me "kurthe".

Zana, ka modeluar një bashkëjetesë me të. E ka ndjekur këmba këmbës, hap pas hapi në rrugëtimin e tij, që nga fëmijëria e deri ditën që kaloi matanë. Është sinkronizuar me jetën e tij, me veprën, me mendimet e me gjykimet. Të jesh në sinkron, të krijosh simbiozë me një qenie tjetër, është "mallkim". Ajo ka depërtuar në raportin e tij me jetën e përditshme, me familjen, gruan, me fëmijët e mbesat, miqtë dhe shokët, sepse i duhet të mendojë, të gjykojë e të veprojë sipas formatit të personazhit që po merr në analizë. Kryesisht, ajo ka depërtuar thellë në dashurinë e pazgjdhshme e pa kushte të Fatmirit me Shqipërinë e shqiptarinë.

Zanës here-herë i është dashur, të shuajë ulërimën e saj të brendshme, që të dëgjojë pëshpërimën e tij. Për studiuesin, siç mund të ketë ndodhur nganjëherë edhe me Zanën, krijohet situatë klaustrofobike, e ngushtë, pa ajër, mbytëse, sepse kthen kokën tek pavarësia e vet dhe tenton të shkëputet, por nuk shpëton dot. Sa më i rëndë të jetë personazhi, aq më e vështirë bëhet distanca që do të mbash me të, për të qenë i kthjellët dhe objektiv. Nuk është e lehtë! Është sflitje!

Mos harrojmë, se Zana sapo mbaron një libër monografik për një artist, duhet të krijojë miqësi, bashkëjetesë, sinkronizim me tjetrin, sikurse aktori që e ndjen personazhin

dhe thelb, por nuk vritet në skenë. Është situatë tampon që i duhet studiuesit të bëjë fshirjen e aromës së paraardhësit. Por edhe të fshish, nuk është e lehtë, sepse të duhet të kthehesh në aromën e lëkurës tënde, të shkosh aty ku je ti, i vetëm me gjykimin tënd të pa infektuar, për të rinisur analizën për tjetrin. Në dukje, bëhet me lehtësi! Gabojmë, ta mendojmë të tillë! Është trafik që nuk ka semafor që e rregullon! Kështu kalon Zana, nga një autor tek tjetri, kohë pas kohe. E bën me stil, për të mos rënë në përsëritje e banalitet. Kurdoherë ja ka dalë më së miri!

Ajo ka bashkëjetuar me Fatmirin për një kohë të gjatë. Ka refuzuar here-herë jetën e saj drejtvizore. Ka "lënë" pas dore familjen, sepse fantazma e Fatmirit i rri përballë dhe i kërkon që të shpiki sa me shpejt "antidotin". Zgjohet natën dhe hedh dy fjalë, që gjumi ja këshillon. Nuk humb kohë të shkojë shpesh me pushime, se i duhet që ta mbyllë letrën 575 faqe. Nervozohet kur e pengojnë dhe të jep përgjigje të alienuar, jashtë bisedës.

Janë ethet e një krijuesi. Nuk kam biseduar me të dhe nuk më ka thënë asgjë për "mundimin" e bukur, por unë e di çfarë ndodh në jetën e një studiuesi serioz siç është Zana.

Pyes veten: A e duam librin të plotë, të vërtetë e të bukur? A duam të dimë rreth udhëtimit të artistit? A duam të dimë prejardhjen, prindërit, vitet e formimit, shoqen e jetës, fëmijët, orët e gjata në studio, pse-në e krijimit, kënaqësinë e realizimit, ngërçet kur shpirti nuk të përgjigjet, dashurinë e miqve, xhelozinë e armiqve, por edhe të

miqve, dështimet, vlerësimet, mërztijen me shkak e pa shkak, vëzhgimin e ambientit ku jeton dhe kënaqësinë e mirëmëngjesi të komshiut?

Kështu bëhet! Është kusht! Nuk bëhet, nëse nuk e rrafshon jetën tënde të përditshme!

E përgëzoj Zanën, që na ka sjelle një monografi të plotë e të shkëlqyer! Një vlerë për publikun artdashës, për studiuesit dhe studentët në njohje të kësaj figure të rëndësishme të artit shqiptar.

Përsëritës fëmijët e Fatmirit, Artanin dhe Arjanën, të cilët e kanë pajisur studiuesen me materiale të shumta e të pa përsëritshme që ruhen në arkivin e familjes, për t'ia lehtësuar punën, që ajo të jetë e plotë në fuqinë e analizës!

Gjithashtu, dua të përsëritës me kënaqësi edhe bashkëpunëtorët e ngushtë të Zanës, për realizimin e këtij botimi, znj. Dhurata Agalliu për redaktimin e librit, znj. Elzana Agolli për dizajnin, z. Mali Pleshti për shtypin, z. Albes Fusha dhe z. Roland Tasho për fotografitë! Janë nga specialistët më cilësorë që kemi sot në tregun e botimeve!

Dhe për ta mbyllur: Këtij artisti, besoj se në vite do t'i dedikohen shumë libra të tjerë studimorë, libra me këndvështrim ndryshe, por ky që prezantohet sot ka fatin të jetë i pari dhe, si i tillë, padyshim do të shërbejë si pikë referimi.

Me kënaqësi do ta pagëzoja si "ungjilli" i Zanës për mjeshterin Fatmir Haxhiu!!!

Myneveri ka lindur në Gjirokastrë më 1924. I ati i saj, nëpunës pyjsh, kishte botëkuptim liberal; rridhte nga një familje e mesme. Ai vetë e kishte kaluar rininë në kurbet, në Amerikë dhe atje ishte shkolluar. Ishte kthyer më 1919 bashkë me fanolistët kur Noli pati vendosur të vinte në Shqipëri.

Vitet e fëmijërisë Myneveri i kaloi në Delvinë, ku u transferua i ati. Pasi mbaroi shkollën fillore me nota të larta, ai e regjistroi në Institutin Femëror në Tiranë. Myneveri sapo kishte mbushur të njëmbëdhjetat. Për herë të parë bënte një rrugë aq të gjatë nëpër Shqipëri. Mbresat e saj për atë udhëtim janë të pashlyeshme.

Duke qenë e zellshme në mësim dhe shumë e hapur në shoqëri, Myneveri fitoi shumë shpejt adhurimin e shoqeve. Mes porosive që i pati dhënë e ëma kur u nis për Tiranë, ishte edhe se "duhej të tregohet e sinqertë dhe e dashur me shoqet, se tash e tutje ato do të ishin familja e saj". Dhe ashtu ndodhi: konvikti; shoqëria; jeta klandestine; jeta në mal; puna në Elbasanin e çliruar; pastaj bashkëjetesa me Dhimitër S. Shuteriqin, një fenomen i rrallë i asaj kohe; jeta shoqërore; Librazhdi; Tirana; familja e re; Fakulteti Gjuhë dhe Letërsi shqipe; Pogradeci; Durrësi; Vlora; Përmeti; Shkodra; miqësitë e panumërta; Moskë; Beogradi; Pekini; Rubiku... Një udhëtim i gjatë, tërësisht romanesk që flet për hapësirat e pafundme të jetës shoqërore.

Shkolla ka qenë një vend i dashur për Myneverin si për të gjithë nxënësit që u ecën mbarë mësimi. Përveç notave të larta në lëndët bazë, më 1938 ajo u shpall edhe kampione e shkollës në ping-pong. Ishte ndër të parat edhe në të dyja kurset e gjuhëve të huaja italisht dhe frëngjisht, të cilat iu deshën disa vite më vonë në bazën e shtypit ilegal, që nxirrte buletin kryesisht nga lajmet e radios në gjuhë të huaja për Luftën e Dytë Botërore dhe fillimisht kur punoi në Agjensinë Telegrafike shqiptare pas Çlirimit. Ajo fliste rrjedhshëm italisht dhe frëngjisht deri edhe në vitin e fundit të jetës së saj. Kjo është diçka e jashtëzakonshme. Një grua stoike që nuk u dha deri në çastet kur jeta po zbatonte ligjin e saj të pashmangshëm. Madje ajo ishte e vetëdijshme për këtë fund, sepse në vitin e saj të nëntëdhjetë e nëntë në një kafe pranë shtëpisë, njëherë midis mikeshave të saj, tha: "Unë po jetoj fundin e jetës". Nuk kishte as trishtim dhe as keqardhje, por një natyrshmëri filozofike që e kanë dhuratë ata njerëz që kanë jetuar me vetëdije dhe kanë kapërcyer me trimëri greminat që i shfaqen në jetë pothuajse çdo njeriu. Shprehja, *kuptimi i jetës* tregon për origjinën, natyrën dhe finalitetin e jetës, ose përgjithësisht të ekzistencës dhe në mënyrë të veçantë të ekzistencës njerëzore. Kjo pikëpyetje metafizike shpesh gjendet në formën e një serie pyetjesh, nga të cilat e para "Cilët jemi ne?", lidhet edhe me kulturat fetare, intelektuale, filozofike dhe kanë sjellë përgjigje të ndryshme, madje kontradiktore. Myneveri u përkiste atyre njerëve që e shohin jetën në sy me guxim dhe me përgjegjësi. Ajo kurrë nuk kërkoi nga të tjerët atë që duhej ta kryente vetë. Dhe nuk tha në shtratin e vdekjes "Ç'po bëhet me mua?", por "Kam qenë një grua me fat", madje, deri disa ditë para se të mbyllte sytë.

\*

Vitet që kaloi në Institutin e vajzave i dhanë Myneverit një kulturë të përgjithshme të qëndrueshme. Asaj i pëlqente shumë letërsia dhe jeta letrare në përgjithësi. Lexonte autorë të përkthyer, por edhe në italisht, si Dante Alighieri,

21 qershor 1924 - 21 nëntor 2024

## MYNEVER SHUTERIQI - FICO U SHUA


Nga Feride Pappleka



Tolstoi, Dostoyevski, Dumas e të tjerë. Lexonte edhe autorë shqiptarë, sidomos ata të Rilindjes Kombëtare. Në prag të pushtimit dhe pas pushtimit në shkollë u kryen mjaft manifestime antifashiste. "Në krye të tyre ishte Margarita Tutulani, Ramize Gjebrea, Nexhmije Xhuglini, Fiqret Sanxhaktari, Naxhije Dume, Liri Lubonja e të tjera" Idetë e reja e tërhiqnin vajzën gjirokastrite dhe u bënë të kuptueshme kur erdhi t'i vazhdonte dy vitet e fundit në Normalen e Elbasanit ku edhe kishte ardhur të banonte familja e saj.

Qyteti i Elbasanit i solli risi në jetë. Ajo kishte lidhur miqësi me të rinj e të reja

antifashistë, si Llambi Peçini, Aleksandra Shuteriqi, Thoma Kalefi (dëshmor i atdheut), e të tjerë që bisedonin për një botë të re që do të vinte edhe në Shqipëri. Ajo shkonte rregullisht në bibliotekën e qytetit, gjë që nuk ishte e zakonshme për vajzat e asaj kohe. Në një koleksion të revistës *Bota e re* e vitit 1938, ajo lexoi edhe botimet e një shkrimtari të panjohur për të, Dhimitër S. Shuteriqi. I bëri përshtypje sidomos poezia *Vdekja e peshkatarit*. Lexoi edhe ndonjë tregim. E pëlqeu mënyrën si shkruante, por imazhi që krijoi për autorin, është i çuditshëm. Nga temat që trajtonte, ai iu duk i moshuar.



Me Dhimitër S. Shuteriqin, Gjinari, shtator 1944.

Më 1943, kur Myneveri ishte në maturë, shkolla Normale u mbyll. Diplomën e mori pas Çlirimit si shumë të tjerë. Kështu ajo filloi veprimtarinë ilegale me rininë që kishte përfaqëuar idealet për një botë të re. Shpërndante trakte dhe komunikata komuniste, në të cilat bëhej thirrje për luftë deri në fitore kundër nazifashistëve. Dhe erdhi kështu arrestimi i parë. Pastaj edhe arrestimi i dytë.

Veprimtaria ilegale sa vinte dhe shtohet, por ajo nuk mendonte fare për vdekjen. Ishte kohë ideale. Liria e vendit ishte çështja më sublime në jetën e rinisë së asaj kohe. Myneveri u bë gati për të dalë partizane gjithë verën e vitit 1944. Ajo e pati shprehur këtë dëshirë më herët, por i thanë se duhej të priste sa të shprehnin vullnetin edhe vajza të tjera. Dhe ja, shtatori që do ta rreshtonte bashkë me vajza të tjera në radhët e Brigadës XVII Sulmuese, e cila do të përurohej në Gjinari, në vendin e quajtur Fushëkuqe (Fusha e Kuqe), erdhi. Familja e saj ishte e lidhur me Luftën antifashiste. Nga ajo shtëpi u bënë tre luftëtarë të ushtrisë partizane, sepse motra doli partizane fill pas saj dhe vëllai kishte dalë në mal një vit më parë. Ajo u nis nga qyteti me një grup të rinjsh e të rejash një mbrëmje të vonë gushti. Ata e kaluan lumin Shkumbin të kapur dorë për dorë mes valëve të ujit që edhe mund t'i merrte me vete.

Fillimisht u vendosën në fshatin Lleshan dhe punuan në terren duke bërë propagandë për fitoren mbi pushtuesit. E mësuar në kushte të një jete qytetare, ajo njohu skamjen dhe jetën e mjerë të fshatit. Njerëzit flinin mbi rrogoza dhe si nënkresë përdornim një trung prej druri. Hanin bukë tërshëre që mezi kapërdihej se kishte brenda fije kashte që të mbysnin etj.

Ditën e përrimit të Brigadës, ajo ka marrë pamjen e luftëtares së re. Ka shkurtuar flokët dhe ka vënë në kokë kapelen partizane. Veshur edhe me një palë pantallona angleze, me çorape deri në gju, me çantë në shpinë, ajo dhe shoqet e saj shndërrohen në një model të ri për fshataret dhe fshatarët që jetonin në një prapambetje shekullore.

Ndërsa shokëve të tjerë iu komunikua sesi do të shpërndaheshin nëpër kompani dhe skuadra, atë e thërret sekretari politik i qarkorit, Zihni Muço e i komunikon punën në bazën ilegale të shtypit. Ajo e pret disi ftohtë këtë vendim dhe ngurron, sepse kishte dalë „për të luftuar me armë“, por kur i thonë se në grupin e punës do të jetë edhe Dhimitër Shuteriqi, ajo kundërshton hapur, sepse i duket e vështirë të punojë me një shkrimtar. Por vendimi ishte urdhër. Komunistët duhej të shkonin atje ku u thuhej. Ajo pas disa minutash ndodhet ballë për ballë me „shkrimtarin“, ish-mësues në Normale për disa muaj para mbylljes së saj, por që nuk i ka dhënë mësim. Të nesërmen grupi merr rrugën për në bazën e shtypit. „Zyra“ ishte një kasolle e ulët, e veçuar, vend që e dinin vetëm dy a tre njerëz. Një gardh i ndante nga blegërimat e bagëtive.

Qysh atë ditë në mbrëmje ata fillojnë punën. Në mes të "dhomës" kanë improvizuar një "tryezë" me dërrasa. Normalistja regjistron lajmet si ndihmëse









Vëllimi poetik “Idioma”, Botimet Dukagjini

## Dëshmia poetike e Kujtim Shalës

Nga Adil Olluri

Libri poetik “Idioma” i Kujtim M. Shalës, krijues dhe studiues i letërsisë shqipe, i botuar javë më parë nga shtëpia botuese “Dukagjini”, është një lajm i mirë për lexuesit e zellshëm të poezisë shqipe, të cilët sy e vesh mund të presin daljen në dritë të një veprë të qenësishme në letrat tona. Së bashku me veprën poetike “E gjithkohshmja andërr” të Donika Dabishevcit, të botuar muaj më parë nga shtëpia botuese prishtinase “Littera”, përbejnë një dyti të veprave që me plotë kuptimin e fjalës mund të quhen libra poetikë, meqë kanë një sistem poetik dhe një frymë të caktuar ideore e tematike. Përkatësia sistemore e një veprë poetike e dallon atë nga një përmbledhje poezish që ka tema dhe motive të ndryshme. Në rastin e dy veprave të lartcekura, kemi strukturimin e një teme të veçantë dhe inkorporimin e motive që e përplotësojnë këtë temë, siç është kujtimi, dëshmia apo rrëfimi poetik për luftën e fundit në Kosovë.

Kujtim M. Shalën jam mësuar ta shoh më shumë si studiues letërsie dhe interpretues i formave dhe teorive letrare, me theks të veçantë aplikimin e tyre në analizat e veprave të shkrimtarëve të njohur e të vlershëm shqiptarë, ndërsa si poet e kam parë, lexuar dhe vlerësuar te veprat poetike “Sendet”, “Kujtim i zonjës n’zi”, “Sagë”, në të cilat mbizotëron një ligjërim i lakmueshëm metaforik, një tematikë universale dhe një lirikë e hollë e dashurisë. Andaj, leximi i librit poetik “Idioma” ishte një befasi e këndshme për mua, meqë u ndesha me një Kujtim Shalë ndryshe, me një krijues që rrëfen dhe dëshmon përmes vargut poetik, me një poet që na flet me një ligjërim human për luftën e fundit në vendin tonë, për një të kaluar tonë të llahtarshme, për një të shkuar që nuk shqitet dot nga mbamendja e njeriut kosovar. Leximi i librit poetik “Idioma” ishte edhe një habi në kuptimin e mirë të fjalës, meqë u ndesha me në një gjendje shpirtërore të nxjerrë nga kujtesa e poetit dhe vetëdija e tij letrare dhe artistike.

“Idioma” përbëhet nga tri pjesë të mëdha poetike, të titulluara “Idioma”, “Shpina”, “Lëkura”, në të cilat mund të hasim forma të ndryshme të shkrimit dhe ligjërimit poetik, siç mund të jenë poema, poemthi dhe poezia lirike. Si poema mund t’i cilësoj tekstet poetike me titujt “Stacioni i vjetër” dhe “Idioma”, nga e cila edhe e merr titullin libri i Shalës, si poemth mund t’i cilësoj tekstet poetike me titujt “Lista”, “Fundi”, “Ekran i zi” etj, ndërsa si poezi lirike tekstet poetike “Thurima”, “Kafshë e lashtë”, “Shkolla”, “Mësimi”, “Tirania”, “Doracaku”, “Budallai”,

“Dosja”, “Anarkisti” etj. Dua të shtoj se këto janë poezitë që më kanë lënë më së shumti përshtypje gjatë leximit të këtij libri.

Te ky libër poetik i Shalës, veçanërisht te poema “Idioma”, poemthat “Lista”, “Fundi”, “Ekran i zi” etj, e kemi një ligjërim poetik që i ngjanë rrëfimit të vargëzuar, që është atipik për poezinë e tashme shqipe, e cila synon më shumë shpalimin e emocionit dhe mendimit përmes njëjtit figurativ dhe konceptimin e një uni poetik, se sa ndërtimin e një rrëfimi të vargëzuar, të mbarsur me situata, ndodhi, personazhe dhe karaktere, që janë konstruktive tipike për zhanret e prozës artistike. Kjo gjë e bën këtë libër të cilësohet si një vepër poetike me elemente të një narracioni lirik.

“Idioma” na flet për frikën e natyrshme të njeriut kosovar në një kohë kur vdekja trokiste vrullshëm në portat tona, na godiste pashpirtshëm në çdo cep të fshatit apo qytetit tonë. “Idioma” na flet për ikjen tonë, të pavullnetshme dhe të padëshirueshme, për të shpëtuar nga mizoria, duke na shndërruar në një turmë që shpresën më të madhe e kishte te stacioni i trenit, që ishte një vend shprese për të ikur nga vendlindja, si një mundësi për të shpëtuar gjallë. Na flet për kujtimet e subjektivit rrëfyes, rrëfimtari lirik, për dëshmitë e gjyshit për të kaluarën e tij të largët dhe të afërm, si dhe përballjet e vazhdueshme me luftën dhe luftërat, përndjekjen dhe torturën, si një fatum i pandryshueshëm deri në ditët e sotme për njeriun shqiptar të Kosovës. “Idioma” na flet për liribërësit e mbetur në margjina, në harresë dhe të zhurmshmit e pasluftës që rrëmbejnë lavdinë e pamerituar, që do të duhej t’iu takonte të parëve. Na flet për lëndimet shpirtërore të njeriut tonë dhe pasojat që ka lënë lufta e që përcillen edhe shumë vite pas përfundimit të saj. Po ashtu, “Idioma” na rrëfen edhe për veset e njeriut tonë, të rëna në sy në vitet e pasluftës, kur ngarendja pas të fortëve ishte një gjë e zakonshme, e vërejtshme dhe e kudondodhshme.

Titullin e veprës do ta interpretoja në dy rrafshje. Së pari, ashtu siç shpjegohet nga linguistët, idioma është një e folur e veçantë e një grupi shoqëror, përmes së cilës ai dallohet nga një grup tjetër shoqëror. Në këtë prizëm, mund të interpretohet se këtë titull e këtë vepër, poeti e ka krijuar dhe na ka dhënë si një rrëfim autentik për njerëzit e vendit të tij, për ta dhënë dëshminë e tij për vitet e tmerrit nëpër të cilat kaluan ai dhe ata, të dashurit dhe të njohurit e tij. Së dyti, idioma dhe ligjërimi idiomatik është i ndërlikuar me një ligjërim të veçantë, me një ligjërim autentik dhe personal, për një kohë kur jeta dhe vdekja rrinin pranë njëra-tjetrës si në një teh shpate. Ndoshta, lexuesit e tjerë, veçmas ata që kanë njohuri të thella semiologjike mund të nxjerrin edhe më shumë rrafshje leximi dhe interpretimi, por për një shënim të shkurtër për një libër të sapodalë mund edhe të mjaftojnë këto dy rrafshet e mia.

“Idioma” është një rrëfim dhe një dëshmi poetike e Kujtim M. Shalës për luftën, për veten dhe për njerëzit e vendit të tij dhe ballafaqimet e tyre me orën e ligë, të keqen e përbindshme. Letërsia e tashme shqipe e Kosovës ka nevojë për vepra që rrëfejnë dhe dëshmojnë, sikurse ky i Shalës dhe libri i Dabishevcit, për të cilin folëm në fillim të këtij shkrimi, sa njoftues, po aq edhe vlerësues. Asnjëherë nuk bëhet “shumë” të shkruajmë për një temë të gjallë, që na rri gjithnjë zgjuar në honet e mbamendjes sonë.

## SALI BASHOTA

### Çka bëni ju atje të dielën

poezi

#### ÇKA BËNI JU ATJE TË DIEËN

Çka bëni ju atje të dielën  
A dilni në ajër të pastër  
Për gjimnastikë të mëngjesit  
A i përjetoni të gjitha dhimbjet  
Në secilën stinë të vitit  
Si atëherë kur ishit në botën tonë

A iu merr malli ndonjëherë për ne  
Kur çdo ditë shkurtoni vetëm mërzit  
A i merrni shpirtat me vete  
Kur ndizet ai zjarr i madh  
Në ferr e purgator  
Në krojet e parajsës

A flasin me ju poetët  
Pa fluturuar dallëndyshet e detit  
Pa i kryer detyrat e shtëpisë  
Çka iu thonë gratë e bukura  
Sa herë mërzhiteni me heshtjen  
Pa u mësuar kurrë me vdekjen  
Pa ndërruar asnjë fjalë me njëri-tjetrin

A bjen shi atje ende pa shkrirë bora  
Toka a dridhet si në pëllëmbë dore  
Pa u larë në lumenjtë e parajsës  
Të dielave herët në mëngjes  
Ndoshta nuk e keni harruar notin  
As rregullat e reja të lojës

Ku do t’i vjerrni çelësat e përjetësisë  
Pa u ndryshkur nga vetmia  
Pa iu treguar rojtarëve të dashurisë  
Secili mund t’i vjedh kujtimet e  
pashkruara  
Kur i matni hijet me këmbë të zbachura

Mos harroni dritaren mbyllur  
Pa hyrë rrezja e parë e diellit  
Derisa ta njihni vetveten  
Para atyre pasqyrave ngjyrrë varri

Ju çka bëni atje të dielën në mesditë  
Gjumi a iu zë në krahun e djathtë  
Pa lëshuar asnjë ofshamë  
Pa derdhur asnjë pikë lot  
Mos keni frikë nga shpejtësia e territ  
Atje poshtë në udhën e ëndrrave  
Është një qiell tjetër

Çka bëni ju atje të dielën në mbrëmje  
A i pushoni shpirtat në dritën e hënës  
Kur i mbushni çantat me mollë të  
ndaluara  
Me fruta të ëmbla  
Kur i numëroni ngjyrat e ylberit  
Dhe bëheni të lumtur  
Si të parët e asaj bote

Mos flini aty përgjithmonë  
Në shtretërit e bardhë  
Pa çelur gur gojën  
Pikërisht atje do të vijmë të gjithë  
Duke prishur rendin

Atëherë ne  
Çka do të bëjmë atje të dielën

#### Shënim:

Kjo poezi është nderuar me çmimin letrar “Ali Podrimja”, poezia më e mirë, e lexuar në edicionin e 60-të jubilar të Mitingut të Poezisë në Gjakovë, mbajtur më 8 nëntor 2024.

*Me Çmimin “Ali Podrimja” për poezinë më të mirë të lexuar në Orën e Madhe Letrare, është nderuar poeti Sali Bashota për poezinë “Çka bëni ju atje të dielën”, ndërsa fitues i çmimit për librin poetik më të mirë midis dy mitingjeve është nderuar poeti Lulzim Tafa, për librin “Rivali i Adamit”.*

## 60 – VJETORI I MITINGUT TË POEZISË NË GJAKOVË

Klubi Letrar “Gjon Nikollë Kazazi”, organizoi manifestimin tradicional Mitingu i Poezisë në Gjakovë me Akademi Jubilarë, për të shënuar 60 – vjetorin e themelimit.

Siç dihet, Mitingu i Poezisë është themeluar në vitin 1964, në qytetin e Gjakovës, ndërsa shumica e aktiviteteve janë organizuar në bashkëpunim me Shoqatën e Shkrimtarëve të Kosovës. Në ceremoninë solemne me fjalët e tyre përshëndetëse u paraqitën: Ardian Gjini, kryetar i Komunës së Gjakovës, Muharrem Kurti, kryetar i Klubit Letrar “Gjon Nikollë Kazazi”, shkrimtari Jusuf Buxhovi, njëri ndër themeluesit e Mitingut, Agim Byci etj.

U tha, se në aktivitetet e këtij Mitingu, vite më radhë madje edhe në periudha të mbijetesës së fjalës shqipe, përveç shkrimtarëve të Kosovës, kanë marrë pjesë shkrimtarë të njohur nga Shqipëria, si Ismail Kadare, Dritëro Agolli, Fatos Arapi, Xhevahir Spahi, Visar Zhit, Natasha Lako, Fatos Kongoli, Zija Çela e shumë të tjerë, si dhe poetë të shquar nga ish - republikat e Jugosllavisë, si Jasha Zllobec, Jevrem Berković etj.

Në Orën Qendrore të Mitingut, poezitë e tyre i lexuan Sabri Hamiti, Naime Beqiraj, Milazim Krasniqi, Sali Bashota, Lulzim Logu, Lulzim Tafa, Anton Marku, Migena Arllati, Prend Buzhala, Agim Desku etj.


Duke qenë se poezitë i nënshtrohen konkurrimit për çmimin “Ali Podrimja”, fitues i poezisë më të mirë, u shpall poeti Sali Bashota, me poezinë “Çka bëni ju atje të dielën”.

Çmimi letrar për krijues të rinj “Yllka Domi” iu nda katër nxënësve: Sara Gjoshi, Albiona Fetahu, Alisa Kodraj dhe Erjon Xhiha.

Në këtë përvjetor, Klubi Letrar “Gjon Nikollë Kazazi”, ndau Çmime Jubilarë post - mortum, për ish-kryetarin e Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës, Ibrahim Rugova, shkrimtarin Din Mehmeti dhe shkrimtarin Teki Dërvishi. Me Çmime Jubilarë u nderuan Jusuf Buxhovi, Besnik Mustafaj, Sabri Hamiti dhe Agim Byci, ndërsa me Mirënjohje Jubilarë u nderuan Milazim Krasniqi, Agim Vinca, Naime Beqiraj, Jeton Kelmendi, Iljaz Bobaj, Qemajl Juniku, Albert Shala, Karvani i Shkrimtarëve për Fëmijë. Po kështu, me mirënjohje u nderua edhe kryesia e klubit “Gjon Nikollë Kazazi”, Muharrem Kurti, Engjëll I. Berisha, Migena Arllati dhe Vjollca Kuqi, pastaj Blerim Valla dhe Shefqet Dinaj, si dhe mediet Radio Gjakova dhe “Syri Vision”.

Me çmimin tradicional “Din Mehmeti”, për librin më të mirë të botuar midis dy mitingjeve u vlerësua poeti Lulzim Tafa për librin me poezi “Rivali i Adamit”.

Në kuadër të aktiviteteve të Mitingut, u promovua romani “Libri për Gjakovën”, i shkrimtarit Jusuf Buxhovi, dy libra të autores Diana Marku: “Brenga me fytyrë vajze” (poezi) dhe “Të gjithë poshtë urës” (dramë), libri me poezi “Duke prituri ditën e tetë”, i poetit Anton Marku dhe libri me tregime “Albani nuk flet shqip”, i autores Angjelina Marku.





Me dëshirën e përdorimit të të gjitha mjeteve të komunikimit, pianisti Amir Xhakoviç paraqitet para artëdashësve e në veçanti para admiruesve të artit pianistik edhe me këtë CD. E konsideroj një sfidë këtë realizim me vepra pianistike të zgjedhura nga 10 autorë të vëndeve të ballkanit të titulluar "THE BALKAN PIANO" volumi i parë, sfidë e cila bazohet në tre faktorë të rëndësishëm:

1. Amiri tashmë ka një eksperiencë, karrierë e përvojë të pasur artistike;

2. Ka arritur të ketë një njohje të thelluar mbi autorët dhe krijimtarinë pianistike të autorëve të vëndeve që i është rreferuar;

3. Jep një kontribut modest por të rëndësishëm për ta bërë të njohur këtë art dhe për vëllazërimin përmes artit dhe kulturës;

Idea në lidhje me përmbajtjen e kësaj CD-je te pianisti, duket se ka qenë një strategji që ka ardhë duke u realizuar natyrshëm, sepse që në vitin 2022 Amir Xhakoviç paraqitet në koncerte të rëndësishme me "Peizazhe pianistike nga Ballkani".

Gjatë këtyre ditëve pata kënaqësinë që repertori në këtë albumi jo vetëm ta dëgjoj, por edhe të mbaj në duar partiturat e ti shikoj me vëmendje. Prandaj në fjalën time pa u thelluar shumë, do të përiqem të evidentoj disa dukuri që i karakterizojnë **përmbajtjet objektive** dhe **përmbajtjet subjektive** të këtyre veprave, duke mbajtur parasysh se ato janë bërë realitet falë aftësive interpretative teknike dhe artistike të pianistit Amir Xhakoviç.

Albumi hapet me pjesën "DRIVE" (2006) të autores Kroate **Sonja Drakuliç** (1963).

Vepra karakterizohet nga një energji dhe vull zhvillimesh melo-ritmike e harmonike të paqëndrueshme e befasuese. Ndërthurja e copëzave melodike, thyrjeve ritmike kryesisht me faktura të ngjeshura në akorde por edhe melodike, si dhe pasazheve që përshkrijnë vullshëm tastierën, tregojnë një përgatitje të lartë teknike në ekzekutim. Në këtë atmosferë kaq dinamike, mjedisi paraqitet si një moment i qetë e relaksues, por me një situatë të brëndëshme psikologjike që lëvizë edhe në formën e imitacionit. Vepra ka një gjuhë muzikore kontemporane dhe pianisti ka arritur ta realizojë atë me korrektësi, duke organizuar me kreativitet situatat e përshkruara më sipër. Duke dëgjuar e shikuar këtë vepër por edhe ndonjë tjetër të këtij albumi, më vjen mendimi se sot teknologjia e shkrimit dhe përpunimit të materialit muzikor në procesin krijues mund të realizohet edhe me ndihmën e kompjuterit, por **interpretimi mbetet krejtësisht vepër njerëzore**.

Vepra e dytë vjen nga kompozitori Bullgar **Pancho Vladigerov** (1899-1978). Nga "EPISODES" op.36(1941) është zgjedhur pjesa nr. 4 "IMPROVISATION".

Është një vepër e bukur me përshkrime melodike e harmonike pasionante romantike, që përshkohet edhe nga intonacionet popullore të vëndit të origjinës së autorit. Ajo është e ndertuar në një formë tre pjesëshe të përbërë, ku mesi paraqitet si përpunim. Në tërësi vepra ka një logjikë kompozicionale e një unitet të gjuhës muzikore dhe mjeteve artistike të përdorura. Frazat melodike, gjuha harmonike dhe pasazhet pianistike, japin atmosferën e një veprë post romantike. E gjithë kjo vjen e realizuar mjeshtërisht dhe e ngritur në nivelin e një tabloje të pasur ngjyrimesh pasionante, nga loja brilante e Amirit.

Albumi vazhdon me prezantimin e **Suitës për piano** në A major op. 27(1960) të kompozitorit nga Maqedonia **Tomislav Zografski** (1934-2000).

Duke dëgjuar pesë pjesët e shkurtëra të kësaj suite, të krijohet ideja se je duke soditur një ekspozitë me piktura, ku secili nga autorët ka stilin e vet. Pjesa e parë

## DUKE DËGJUAR ALBUMIN "THE BALKAN PIANO" – VOLUMI II-RË TË PIANISTIT AMIR XHAKOVIÇ

Prof. Zef Çoba

SINFONIA në tonalitetin e dritshëm La maxhore, është një allegro e shkruar në stilin e pastër të muzikës barok. Pjesa e dytë INTERMEXO është një andantino në tonalitetin La minor, e trajtuar si një këngë ninulle e qetë. Melodia e saj kalon me elegancë në përdorime intonative kromatike e alteracione. Harmonia karakterizohet nga bashkëtingëllore dizonante dhe surprizon me kandencimin në La maxhore në masen e fundit. Interesant është numri 3 PASSAGGIO që sjell një tjetër brëndë në formën trepjesëshe në të cilën pjesa e mesit në kontrast ka një gjëndje intriguese. Pianisti është treguar i kujdesshëm e kreativ në interpretimin e dy numrave të fundit, që janë të njëjtë me dy numrat e parë. Numri i katërt që është i njëjtë me numrin e dytë që mbante titullin INTERMEXO, tani mban emërtimin ROMANZA, është trajtuar më ngadalë e me ndjesi më poetike. Ndërsa pjesa e pestë Finale, megjithëse është e njëjtë me materialin e pjesës së parë, është trajtuar ritmikisht më shpejt, energji e vull, duke përligj në formë konkluzive përfundimin e krejt veprës.

Nga kompozitorët e Kosovës kemi **Rafet Rudin** (1949) me veprën Preludium "LES CLOCHES ARBËRESH" (1993)

Vepra mban shënimin e autorit **Lugubre** (i zymtë) dhe përshkohet nga një gjëndje me përmbajtje të zymtë e të thellë dramatike. Notat në partiturë janë hedhur pa asnjë kufizim a inkuadrim, që përveç teknikës së përdorur në shkrimin e partiturës, të krijon përshtrypjen e përshkrimin të një mendimi dimensional të shtrirë thellë në kohë. "Këmbanat Arbëreshe" bien dhimbshëm herë lehtë si jehonë e ngarkuar me peshën e ndjenjës së brengës të largët, e herë bien si klithma të forta. Herë me tingëllore në



intervalet kuintë – kuartë që të ngjallin trishtim e boshllëk, e herë si klithma therëse në bashkëtingëllore dizonante. E gjitha kjo e ndërthurur ndërmjet edhe me grumbuj tingujsh të lidhur në copëza melodike me brum intonacionesh kombëtare, që herë ngjajnë si gurgëlloja krojesh e herë si rrëke e ujvara vizatimesh pasionante tingullore. Diku dëgjohej në akorde edhe një korale. Kjo gjëndje e pikëlluar dhe ky peizazh i pasur sonor e artistik, është realizuar me shumë dashuri, kulturë, korrektesë, teknikë e frymëzim.

Autori i pestë në album është **Vojin Komadina** nga Kroacia/ Serbia/ Bosnje-Hercegovina/ Mali i Zi (1933-1997).

Nga ky autor janë zgjedhur "TWO MINUETS" (1985)

Janë dy pjesët të këndëshme e të çiltra pianistike lirike, të dyja në ritmin vallëzues

të valësit në kohën ¾, e para *Andante con moto* dhe e dyta *Andante moderato*. Ato karakterizohen nga një gjuhë muzikore që ndërthur elemente të melosit gazmor popullor, ndertim e formë klasike, shjellime pasionante me kalime harmonike tipike romantike, shpesh edhe me tingëllore dizonante. Interesante janë kalimet melodike të papëgatitura maxhor-minor, në një mënyrë kapriçioze. Kjo atmosferë na vjen e bukur nga një lojë elegante me fraza muzikore të trajtuara shpesh me një rubato të lehtë, dhe me ekuilibre sonore të vendosura me kujdes. Merita e pianistit është se elementët e ndryshëm stilistikë të përdorura në të dyja miniaturat nga autori, i ka studiuar me kujdes e me maturi e i ka bërë një frymë në unitet e në funksion të mendimit artistik të autorit.

Një tjetër gjuhë e stil muzike sjell vepra "AWAKENING" (Zgjimet) e autorit Dusan Bavdek (1971) nga Sllovenia.

Kjo vepër e kompozuar në vitin 2010 është shkruar me një gjuhë mjetesh muzikore bashkëkohore dhe karakterizohet nga shumë ndryshime agogjike. Fillon me një strukturë ritmike konvencionale të vendosur në regjistër shumë të lartë të instrumentit në një notë të vetme në pianissimo, e gradualisht parti pasurohet e bëhet aktiv me kalime pasazhesh pianistike impenjative në aspektin teknik, në të cilin dëgjohej e fshehur si lajmotiv figura konvencionale. E gjithë kjo lojë është tejet e pasur me vizatime e ngjyrimesh ekspresive dinamike me rritje graduale, me kontraste e kulminacione, me përdorimin e zhdërvjellët të krejt diapazonit të tastierës. Arpezhiat e vendosura në bashkëtingëllore dhe akordet dizonante, e rrisin më tej tensionin duke krijuar efekte me impresione e përmbajtje ekspresioniste. Pa hyrë në detaje të veçanta të mudësive të instrumentit, ndihet vëçanarisht efekti sonor që krijohet edhe nga përdorimi i pedalit. Në disa raste kalimet ledhatuese sonore, të ngjajnë në vezullime vibruese. Vepra mbyllet me figuren ritmike konvencionale që paraqitet me mjete ekstremisht të kursyera, e vendosur në notën Si në regjistër të lartë në pianissimo, që ngjan "si një pupël vallëzuese". Kjo vepër delikate është realizuar nga Amiri me një artikullim perfekt e organizim organik të partit muzikor mjaft kompleks.

Nga repertori që Amiri padyshim ka njohur ma mirë, ai Shqiptar, ka zgjedhur nga Aleksander Peçi (1951) veprën "BAROKJARE" (2013).

Titulli "BAROKJARE" që është i përbërë nga emërtimet "Barok", stili i epokës që në muzikë zgjati ndërmjet viteve 1600-1750, dhe "Jare" grupimi i repertorit brilant të këngëve qytetare shkodrane, si dhe elementët me tendencë të përdorë në artin e tij, përbëjnë thelbin e logjikës kompozicionale dhe pikat mbështetëse të lëvrimin të mendimit krijues që Peçi ka përdorur në ekuilibër për krijimin e kësaj veprë. E konsideroj një vlerësim që autori i bën jares shkodrane duke e bashkuar me një emërtim që ka bërë epokë.

Është zgjedhur tonaliteti melankonik Sol minore për një shtjellim të pastër melodik. Njëra pas tjetrës frazat muzikore shtrihen në kohën ¾ në Adagio, të pasuruara me zburime melodike e melisma, që hijeshojnë si qëndisi të punuara me shumë shpirt, dashuri e pasion. Në sfond një fakturë funksionale dhe e kursyer harmonike, evidenton thjeshtë e bukur kalimet e shmangiet e sekuencave melodike të frymëzuara, herë me trajtime e alterime të papitura elementësh intonative kromatike, e nganjëherë që na kujtojnë kadencimet e dashura e të sheqerosura të këngëve popullore lirike shkodrane. Duke dëgjuar këtë realizim, më vjen të them se kemi të bëjmë me një frymëzim që mban dy dashuri: *dashurinë*





**e autorit për Shkodrën dhe botën e pasur lirike e origjinale të këngëve shkodrane, dhe natyrshëm dashurinë e pianistit për qytetin e tij të lindjes, për natyrën e për bukuritë e shpirtit njerëzor, pjesë e së cilës është edhe ai vetë.**

Aleksandar Perunoviç(1978) nga Mali I Zi është autori i radhës, me veprën **“METAGLASSWORK”**(2014)

Në këtë vepër përveç të gjitha mundësive shprehëse muzikore të instrumentit, janë vendosur nga autori në partiturë edhe të tjera efekte sonore si goditje të pedalit, goditje nga sipër e instrumentit dhe prekje të lehta tingush në akorde. Pavarësisht se vepra në hyrje dhe mbyllje ka një gjendje të qetë ku dëgjohen tinguj që përbëjnë akordin do minore, e gjitha shtjellohet në një tension psikologjik dhe ankth. Shënimi *Allegro inquieto* hap siparin e një situatë alarmante. Vepra zhvillohet vullshëm si një tokatë me ndryshime të shpeshta dinamike e strukturash ritmike, që krijojnë një gjendje maramendëse, në të cilën i vetmi që për asnjë çast nuk duhet të humbasë mendjen është pianisti. Aftësitë e mira teknike të Amirit, bëjnë që sfida të realizohet mjeshtërisht dhe të përcillet ide artistike. Coda kthen gjendjen e parë, por tingujt e Do minorit tashmë realizohen me pickimin e telave në picikato.

Përdorimi i pedalit për shumë efekte sonore është thujtë në të gjitha veprat kontemporane, ashtu si edhe në këtë vepër.

Kompozitori i njohur nga Serbia Milan Mihajloviç(1945) është i zgjedhuri i Amirit për të qenë pjesë e albumit me **“TREE PRELUDES”**(1986-1989)

Gjuha dhe logjika kompozicionale që i karakterizon të tria këto vepra të vogla pianistike, është e njëjtë dhe tregon qartë dorën dhe stilin që ka përdorur autori. Janë bashkuar bukur dhe mirë mundësitë shprehëse dhe teknike të instrumentit të pianos, me përshkrime impresioniste sonore melodike, harmonike dhe një sfond që lëviz me vizatime pasazhesh.

Preludi i parë **Andante sostenuto** - fillon me një hyrje të qetë dhe vazhdon me një part që kërkon ekuilibër në mes mendimit që mbart melodinë në dorën e majtë dhe dorës së djathtë që si sfond lëviz me pasazhe të gjalla.

Preludi i dytë **Non lento** - është një pjesë me përshkrime të qeta meditative.

Preludi i tretë **Allegro** - ashtu si i pari

mban në dorën e majtë idenë në konture të qarta melodike, ndërsa dora e djathtë lëviz me pasazhe të gjalla duke krijuar në tërësi gjendje të paqëndrueshme. Preludi mbyllet ashtu si fillon i pari *Andante sostenuto*, duke krijuar një gjendje të qetë – meditative, dhe duke na kujtuar disa intonacione e kalime melodike të dëgjura më parë.

Albumi mbyllet me veprën **JETTATURA** (1999) të kompozitorit Grek John Psathas (1966)

Duke lexuar informacionin në lidhje me titullin, mësova se Jettatura apo mal occhio ka të bëjë me syrin e keq. Pra jettatura, apo syri i keq sipas një bestytënie të lashtë, është vështrimi me zili që hedh magji të keqe, të padëshiruar në jetën e dikujt.

Vepra është një moto perpetuo me energji të lartë, e shkruar me një part impenjativ me shtrirje të gjërë gjendjesh emocionale. Fakturat e gjalla shtrihen nga regjistri i ulët në dorën e majtë duke goditur tastjerën me forcë dramatike, deri tek tingujt ma të lartë që fluturon të godasë dora e djathtë. Ndryshimet agogjike ritmike me ndryshimet e gjendjeve dinamike nga pianissimot deri tek sforçantot e klithmat me tre forte, janë evidente. Në bulëzat melodike të fshehura mes pasazheve pianistike, dëgjohen karakteristikat modale të muzikës greke. Interesant janë artikulet e tingujve të çveshur melodik në regjistrë shumë të lartë të instrumentit, që ngajnë si pëshpërime e cicërima enigmatike e të padeshifrueshme zogjesh. Kjo vepër e relizuar me sukses në këtë album, për pianistët e klasit është një provë serioze e një sfide që kërkon përgatitje shumë të lartë teknike e artistike.

Në përfundim dua të them se kujdesi për ta bërë të mundur realizimin me sukses të albumit **THE BALKAN PIANO Volumi One**, e ka vënë Amirin në kërkim për të gjetur kushtet e duhura duke bërë të mundur regjistrimin në Sallen e Koncerteve në Shtëpinë Svetosavski në Nish të Serbisë me datën 05 mars 2024, duke luajtur në instrumentin e markës C. BACHSTEIN D 282 Concert Grand, si dhe duke siguruar bashkëpunimin me agjensinë prestigjioze **TOCCATA CLASSICS**.

Me prezantimin e këtij albumi, pianisti Amir Xhakoviç i ka bërë një shërbim artit muzikorë, kulturës tonë dhe rajonit të Ballkanit.

Shkodër, me 26.10.2024

## EQREM BASHA, LULZIM TAFI DHE TIMO FLLOKO – FITUES TË ÇMIMIT “AZEM SHKRELI”

Në një atmosferë tipike poetike siç e meriton poezia e Azem Shkrelit, në qytetin e bukur të Pejës, u mbajtën Takimeve Letrare Ndërkombëtare “Azem Shkrelit”. Para publikut të zgjedhur pejan dhe të huaj, u deklamuan vargje nga poetë shqiptarë dhe të huaj, u mbajt një debat letrar, u ndanë çmime letrare dhe pati një kohë të mirë shoqërimi në mes poetësh.

Takimet u hapën me deklamimin e poezive të Shkrelit nga aktori Timo Flloko e më pas vargjet e tyre i deklamuan poetët: Lindita Aliu Tahiri, Sultan Cato (SHBA), Lulzim Tafa, Alfons Zeneli, Donika Dabishevc, Eqrem Basha, Constantin Barbu (Rumani), Jeton Kelmendi, Engjëll I. Berisha dhe Timo Flloko. U ekzekutuan edhe vepra muzikore dhe u interpretuan arie muzikore.

Juria në përbërje: Ali Aliu, Naime Beqiraj dhe Valon Shkrelit (i biri Azem Shkrelit), i ndanë çmim për letërsi poetit Eqrem Basha kurse për teatër dhe kinematografi aktorit Timo Flloko. Ndërsa këtë vit, për herë të parë u nda çmimi “Lirikë me shi” (sipas titullit të veprës së Azem Shkrelit) i cili i takoi poetit Lulzim Tafa për poezinë “Sa shpejt më harroi Nana”. Çmimet u ndanë nga Kryetari i Pejës Gazmend Muhaxheri

Dita e dytë e takimeve ishte në shenjë të një tribune letrare me krijues e studiues shqiptarë me temën “Ndikimi i poezisë së Azem Shkrelit në letërsinë shqipe”. Në këtë tribunë që u moderua nga studiuesi Sali Bashota, kumtesat e tyre i paraqitën studiuesi Ali Aliu dhe poetët Naime Beqiraj, Murteza Osdautaj dhe Alfons Zeneli të cilët e vlerësuan poezinë e Shkrelit si njërin nga më të arrirat në letërsinë shqipe.

Ky organizim me plot finesa u organizua nga Drejtoria e Kulturës së Pejës dhe u moderua nga vet Drejtoresha për Kulturë e këtij qyteti Xhenet Syka.

Këto takime, Komuna e Pejës i organizon për herë të XX por lirikun e madh i cili u lind më 1938 në Shkrel afër Pejës dhe ndërroi jetë në Prishtinë në vitin 1997.





*Karikaturë nga Arben Meksi*

## MAMASË

Të mbaj mend  
me lugën në dorë  
duke trazuar gjellën  
veshur me një palë tuta të babait,  
me një legen ngjyrë blu të thyer anash,  
me një dorë në brumë ku shpesh të binte unaza  
(njëherë kur doli tek copa ime e bukës  
ta dhash si dhuratë për 8 mars).  
Të mbaj mend me shatin në krah  
e dorën në brez (ndoshta prej dhimbjesh)  
ahere sikur më dëshmoje: unë ia dal,  
ja, ndër dhëmbë po përtyp vetminë  
ja, edhe tënd at, edhe Greqinë.

Të mbaj mend me dy bidona uthulle në duar  
që i mbushje me ujë në kroit e fshatit.  
Të vija pas për ndihmë dhe të bëhesha pengesë.  
Të mbaj mend tek bëje punë burrash  
që të rrisje burra.

Ta mbaj mend madje edhe lëkurën e bardhë  
që u zhbë befaz si sekuencë filmike.  
U bëre tra për shtëpinë,  
baba për ne  
dhe grua për burrin.  
Tash rolet më ngatërrohen  
dhe poezia ma humbet fillin.  
Po e lë këtë strofë.

“Do shkosh tek burri”  
është fraza që tash ia beh prej teje  
sikur po flet për xhelatin.  
Burrit dhe jetës së burrit  
ia jep trajta të rënda  
nga frikë mos gjërat bëhen ciklike.  
E di, do që jot bijë mbetet një vajzë  
asesi një nuse;

as e ve, as e martuar, as e divorcuar.  
Të mbaj mend  
tek motrave iu thojë nën dhëmbë  
“mos e paçi fatin tim”,  
e atëherë shashtisja  
tek rrokja veç dështime kuptimesh.  
Tani them vetë: mos e paçin fatin tënd.

## MË NDJENI PËR MUNGESËN E ETIKËS!

Kam kohë që e di se gjërat nuk ndreqen  
por premtimet nuk i ndal për inerci  
ndoshta sepse s’di tjetër ç’të bëj  
me këtë fat të lëmuar nga montonia.

Rrah të çel diku tjetër  
ndoshta planet  
a (mjafton) kudo në tjera kushte  
me parakushte  
dhe veten në grushte  
ta mbaj  
si letër e zbutur nga djersët e kohë së shkuar.

Kam kohë që e di se kjo botë iu përket budallenjëve,  
më ndjeni për mungesën e etikës,  
madje edhe për mungesën e frikës  
që pranoj se kjo botë, seriozisht, iu përket  
budallenjëve,  
që ia dhanë luksin vetes të jenë të qetë,  
pa e ndërlikuar jetën me metafora.

Kam shumë kohë që e di se nuk mund të çel diku  
tjetër  
edhe se kjo botë më lë zbrazëtira si gazrat në  
stomak...  
booh, më falni për mungesën etikës,  
dhe për mungesën e frikës,  
por kam kohë që e di se nuk mund të çel diku tjetër  
veç kësaj bote të vjetër  
me histori të pafavorshme për të bërë historinë time.

Kam kohë që e di se gjërat nuk ndreqen  
dhe veten nuk ndalem së gënjeri.



## ALBAN TUFA

## Më ndjeni për mungesën e etikës!

Cikël me poezi

Kështu që më falni për mungesën e etikës  
dhe për mungesën e frikës  
që veten nuk ngopem se ngrëni.

\*\*\*

Ti do, e mendjen ta gërric një dehje e athtë ambicijeje,  
tejpërtej tash iu shkon rrathëve metafizik të  
çështjeve.

Të duket e ëmbël rrasa e tultë, gatuar kutrum prej  
rasteve  
E tultë apet të ngjet, e rrashfët sa s’ka, pamja në  
ngasjet e çasteve.

E ëmbël është nisja- mbetet veç aq, pikë e lënë pas  
shpine.  
Tash kujt po i mbrumet Pritja e Fundme tutje tokës  
së përhime?!

Për besë (!) ia beh papritun fundi, s’ka më ngasje të  
athtë ambicijeje,  
tejpërtej iu shkon rrathëve fizik, të vdekjeve, të  
ngjizjeve.

## CURRICULIUM VITAE

EMRI: mund të ndërrohet me një vendim gjykate  
dhe kam tre të tillë në rrjete sociale.  
Tash çerek shekulli jetë nuk kam bërë kurrëfar emri.  
MBIEMRI: po soset që prej kohës kur vdiq im gjysh.  
MOSHA: shpirt sa m’ka lind, mendja ka nis me vdekë.  
VENDLINJA: në këndin më të përthyer të botës.  
VENDBANIMI: në zemrën e dikujt që s’e di as vetë ku  
i ka dhënë tertip.  
ARSIMI: student i fakulteti të shpritrave tallës,  
diplomuar poet nga barku i nënës.  
STATUSI: i ve, më vdiqën dëshirat para do kohe.  
GJUHA: poetike, prozaikë me zanore e bashtingëllore.  
TË TJERA: blej rroba të përdorura në tregun e qyteti  
por kurrë pantollona,  
sepse janë një pjesë e identitetit.  
pi makiato pa shkumë në njëjtën kafe,  
lexoj poezi për inatë të askujt,  
shkruaj çfarë nuk shoh dhe shoh çfarë shkruaj,  
nuk kam kohë të lirë se jam i zënë me konceptin bazë  
të lirisë: fjalën,  
shpesh nuk di çfarë bëj,  
ku shkoj,  
kush jam,  
pse jam,  
por fill bindem se jam njeri

aspak i veçantë,  
asi siç janë miliona (shqiptar, edhe pse nuk lexojnë  
poezi).  
EDHE TË TJERA:  
asgjë,  
asgjë ...dhe diç më pak se asgjë.

Reklamat  
nga VERSEJ SAVIÇ

Një brisk që rruan një fytyrë pa qime  
duket si një gënjeshtër e verbalizuar pa takt.  
“Ulje mbi shtatëdhjetë përqind”  
rrinë si premtim elektoral,  
ku të gjithë e dinë se nuk plotësohet kurrë  
por iu kande ta besojnë.

“Plot dhurata për ju” ngjan si parullë komuniste  
që të thotë mos jeto,  
sepse ne ta ofrojmë jetën me çmim të ulët  
edhe në një gotë qelqi.

Madje reklama futet në mes të filmit  
si stërdhëmbi mes dhëmballëve  
e të jep veç siklet.

Të veshura plot metafora që sqëndrojnë,  
fytyra që nuk ofrojnë asgjë,  
veç buzëqeshjes që rreket të shesë produktin me  
buzëqeshje.

Kur shoh reklama jeta më duket më e thjeshtë,  
e zhveshur nga mërzitë.

Shoh artikuj që nuk më hyjnë në punë  
sepse kurrë s’do mund t’i blej,  
që duan të kumtojnë prezencën  
si nxënës në filllore: këtu.

Qytetin nuk e zotërojnë më njerëzit  
por reklamat e shprehura në terma si mish i huaj,  
madje edhe me termin patetik: reklamë artistike.

Në kodra u thanë pemët  
dhe mbinë reklamat.  
Këto të sotmet  
kanë zëvendësuar parullat e djeshme  
të dyja të mbajnë peng mendjen  
asnjëra s’të bën dobi.  
Njëra do me të zbrazë xhepin,  
tjetra donte me të zbrazë shpirtin.

Përktheu Alban Tufa





- Këtë histori ma ka treguar një burrë nga Mokra, - vazhdoi im gjysh. - Duhet të ketë ndodhur në ato fshatrat mbi Mokër, por unë nuk e mbaj mend tani se nga më tha se ishte tamam ai që ma tregoi. Ndoshta nuk ishte nga Mokra fare, por mua m'u duk se tha ashtu. U ndodhëm rastësisht bashkë në një shtëpi të braktisur, nga ato të muhaxhirëve, që tani shërbejnë apostafat për njerëzit që i zë nata në udhë. Ata që kishin qenë natën para nesh, duhet të qenë esnafë se na kishin lënë një krahë dru pa djegur.

Dhe zjarr bëme shpejt. Hëngrëm bukën që patëm dhe po rrinim. Dhoma qe e errët, ndriçonte vetëm zjarri në oxhak. Po flisnim se ç'hall na pati nxjerr nga shtëpia, kur qëlloi që na u avit një flutur e madhe në dhomë, që e ndillte drita dhe që unë desha ta vras.

-Mooooos! - klithi mokrari. - Pafsha të gjithë shenjtorët, mos e bëj!

Unë e vështrova me habi.

-Thjesht një flutur është, - thashë, - që s'po na lë të flasim rehat.

- Jo, atë s'e dimë as ti as unë çfarë është, - ma ktheu.

Dhe mokrari zuri të tregonte historinë e një djali, që një natë me shi, erë dhe rrufe, i qe shfaqur brenda dhomës një flutur e madhe sa pëllëmba e dorës - nga ato që duket sikur kanë sy në flatra, dhe i vërtitej vërdallë llambës me vajguri. Dhe ky qenkësh afruar, i paska rënë me pëllëmbë, mirëpo flutura paska lëshuar një rënkim si klithmë njeriu dhe pati dhënë shpirt në dysheme. Djali qe vetëm në shtëpi se qe jetim, ndaj s'kishte kë të thërriste tjetër.

I penduar deshi të merrte llambën, të shikonte fluturën nëse pati dhënë shpirt, por krahu nuk i lëvizte. I qe paralizuar si me magji. I trembur, ky pati kënduar nja dy këngë ungjilli, që ia pati mësuar nëna, këngë pendese dhe lutjeje, pastaj kishte rënë të flinte, me shpresën se kjo gjendje do i kalonte.

Por në mëngjes, krahu nuk mundi ta lëvizte që nuk mundi. I bëhej sikur ia kishin mbërthyer me morsetë hekuri.

I dëshpëruar vendosi të kërkonte ndihmë të murgu Zorad, që jetonte në Manastirin e Gurit, dy sahat rrugë më larg nga fshati ku jetonte. Murgun e gjeti në oborrin e manastirit të vjetër, duke krasitur trëndafilat. Zoradi nuk e la të fliste. Ai i dinte të gjitha. E dinte edhe pse kishte ardhur djali, ndaj pa e lejuar të afrohet mirë i tha:

- Je penduar që e vrave?

-Shumë, - tha djali gati në të shkrehur në vaj, - aq sa jam gati të bëj gjithçka për të ndrequr gabimin tim.

Atëherë murgu e urdhëroi ta ndiqte. Djali, që quhej Silorad, vajti pas dhe të dy u futën brenda në manastir. Pastaj ndoqën një kthinë të errët dhe dolën në një dhomë që kishte vetëm një dritare me qelqet ngjyrë vjollcë dhe blu. Murgu bëri kryqin dhe i tregoi një libër të madh që ishte sa madhësia e një tryeze buke. Dhe kërkoi në të emrin e të ardhurit.

- Çne emri im aty?! - tha djali i çuditur.

- Të gjithë banorët e fshatit e kanë emrin këtu, ja ku je edhe ti, - u gjegj murgu dhe i tregoi faqen e librit ku qe emri i tij. - Ja moti i lindjes sate, - i dëfiteu, - ja dita e vdekjes së babait, ja e nënës. - Të gjitha këto qenë të paraqitura me vizatime grafike të bëra me laps plumbi. Në fund të çdo ndodhie, qe vula e unazës së shenjtë që mbante Zoradi në dorë, si drejtues i manastirit.



## ERVIN NEZHA

### Mos e prek fluturën

Tregim

- Ja, - tha, - më poshtë, grafika e një fluturë që duhet ta kem shënuar para një jave, këtu qëndron mëkati yt i rëndë. Tani të shohim se ç'duhet të bësh që të lash mëkatin. Dhe murgu këmbëu faqen e librit. Mirëpo faqja tjetër qe bosh.

- Këtu nuk paska gjë, - tha murgu, - sepse, si duket, nuk kam parë më vegime të reja për ty.

- Po tani, - pyeti i dëshpëruar djali, - si t'ia bëj?

- Tani duhet të kërkoesh eremitin, që rri në Shpellën e Kokutës, vetëm ai mund të të tregojë të vërtetën, se si të veprosh për të larë mëkatin dhe të ndreqësh krahu. Ndoshta ai e ka gjetur lumturinë dhe paqen dhe të tregon edhe ty.

Siloradi u nis, kaloi Malin e lartë të Valironishtit, ledhet e mëdha të Pesëgegës dhe u ndal. Qe vapë e madhe dhe dëgjohej kënga e gjinkallës.

Nga i nxehti i padurueshëm, Siloradi ra në një krua. Aty piu ujë dhe e mori një gjumë i rëndë. Fjeti aq shumë, sa nuk e dinte sa kohë kishte kaluar kur u zgjua. Veçse pa se nuk qe më në krua, por brenda një shpelle. E trembi vetëm hija e një njeriu që po afrohej me një pishë të ndezur.

- Ky do jetë eremiti i shenjtë, - tha, - po ky duhet të jetë, por unë nuk e mbaj mend si erdha gjer këtu.

Dhe vërtet murgu u prezantua si eremiti i Shpellës së Kokutës.

- Si përfundova unë këtu? - tha Siloradi.

- Të gjeta te Kroji i Turtullit, të rrëzuar në njërin krah, - u përgjigj murgu, - si duket e kishe zënë krahu keq dhe e ke thyer. Ndaj ta fashova.

- Jo, - tha burri, - ai m'u sëmur fill pas

asaj nate kur vrava një flutur të madhe brenda shtëpisë sime.

-Ashtu ë? Shih-shih! - u çudit eremiti.

- Pastaj shkova te murgu Zorad, i cili më tregoi librin e shenjtë të jetës, por as atje nuk kishte gjë. Ndaj ai më nisi të të takoja ty, për të mësuar marifetin që do më falë mëkatin e rëndë.

- Ti ke takuar Zoradin dhe ke parë librin e shenjtë? - pyeti i çuditur eremiti, dhe ra në gjunjë dhe zuri të bëjë kryqin.

- Kjo nuk ka mundësi, - tha, - sepse askush nuk e di se ku ndodhet libri i shenjtë i jetëve dhe Zoradi tanimë duhet të ketë vdekur, sepse kam kohë që në qiell, shikoj një yll të ri, që shkëlqen ndryshe nga të tjerët, afër Yllit të Madh të Veriut. Dhe mendoja se qe shëmbëlltyra e Zoradit të shenjtë, që gjithë jetën ia kushtoi Zotit tonë të lavdishëm.

Por Siloradi këmbënguli se Zoradi qe gjallë, qe i plakur, por prapë mbahej mirë.

Atëherë eremiti i tha se faqja që qëndronte bosh në libër, duhej të qe lënë enkas. Kjo u kishte ndodhur edhe të tjerëve që, kur kishin bërë një mëkat të madh, i shenjtë Zorad, por edhe paraardhësi i tij Zadel, që linin të shkruar simbole misterioze të para si vegime, me sa duket nuk mundeshin të parashikonin dot më tepër, se çfarë duhet të bënin këta fatkeq. Ose ata mendonin se këta njerëz duhet ta gjenin vetë udhën për larjen e mëkatit, ndaj nuk shkruanin asgjë.

Eremiti i tha burrit se i takonte atij ta lante mëkatin që pati bërë, pa ndihmën e librit të shenjtë. Dhe të dy u përshëndetën.

Duke u kthyer në fshat, djali e ndau mendjen që të bëhej murg. Kështu, duke

iu lutur përditë perëndisë, do mund të lante mëkatin dhe paraliza do t'i largohej nga trupi. Dhe shkoi te Zoradi i shenjtë. I tregoi ato që kish folur me eremitin, por i tha se tani pati vendosur që pjesën tjetër ta kalonte si murg në shtëpinë e zotit, me shpresën se do ta zbuste zemërimin e perëndisë, që e dënoi.

Dhe kaluan kështu mjaft ditë. Zoradi i mësoi djalit punët e lutjes, punët e manastirit. Dhe vetëm kur u bind se të dhënat e tij si murg qenë shumë të mira, i mësoi të pinte një lëng që përgatitej nga një bimë e rrallë mjedre, e cila të krijonte vegime. Dhe sa herë pinte nga ajo, duhet të shkonte te dhoma e errët, kur Zoradi të mos qe më, dhe të shënonte në librin e madh çfarë shikonte.

Një ditë Zoradi vdiq. Dhe punët e manastirit i mori në dorë Siloradi, që tashmë qe bërë burrë. Një ditë, tekso po pinte shurupin e mjedres, ai pa një vegim të çuditshëm. Pa një vend ku bëhej një luftë e madhe dhe pa një foshnjë që vdiq në duart e nënës së vet. Shpirti iu bë flutur, si ajo që pati vlarë dhe fluturoi lart në qiell. Burri po e sfiliste veten, por donte që atë ëndërr ta shikonte gjer në fund. Dhe pastaj shpirti i fëmijës, i bërë flutur, fluturoi në hapësirat e pamata të botës. Kaloi malet e mëdha të mbuluara nga bora, kaloi luginat e gjelbra me pisha, kaloi kreshta me shkëmbinj të ashpër, e më në fund, u ndal në një krua me ujë të ftohtë. U ul të pijë, por krahet i kishte të dobët nga lodhja dhe ra brenda pellgut të kroit, ku rrezikonte të mbytej. Atëherë kur ëndrra po shkonte drejt fundit dhe flutura po mbytej, burri pa një dorë që u zhyt brenda pellgut dhe e nxori me kujdes lart, e vendosi në lastarin e një rrushi të egër dhe e la të thahej në diell.

Siloradi pastaj doli nga kllapia dhe qe i bindur se ëndrra qe çelësi për të larë mëkatin e madh. Kështu fshehu librin e shenjtë poshtë gurit të madh të altarit, kyçi manastirin dhe u nis të kërkonte një flutur pranë një burimi. Shëtiti krua më krua, por nuk gjeti asnjë të tillë. U lodh e u dëshpërua sa më s'ka, gjersa kur po rrinte në një hije arre, dëgjoi një zë që thërriste në pyll. Burri u fut brenda pyllit dhe pa se një fëmijë po kërkonte ndihmë për shokun që po mbytej në një liqen të vogël. Siloradi mbërriti në kohë dhe pa e gjykuar se ishte vetëm me një krah u hodh të shpëtonte fëmijën që qe në rrezik dhe e nxori lart, sepse fëmija qe i lehtë. Sapo fëmija mori thellë frymë, ai ndjeu fuqinë ti kthehej në krahu që e kishte pasur të paralizuar.

Kështu doli nga uji, bashkë me fëmijën dhe pastaj i qortoi rëndë të dy, por ata nuk flisnin. Gjersa fryu një erë e fortë dhe i mori imazhet e tyre si të qenë krijuar me petale trëndafilat. Burri i çuditur, por edhe i lumtur u ul në tokë dhe falënderoi perëndinë që i ktheu forcën e krahut. Pastaj u nis drejt manastirit, të plotësonte faqen e librit të shenjtë që ishte bosh. Dhe pasi mbërriti, pa vënë gjë në gojë, shkoi drejt altarit, bëri kryqin me duar dhe nxori që andej librin e shenjtë. E hapi te faqja që kërkonte dhe mbeti i habitur. Në të qenë skicuar dy duar drejt njëra-tjetrës, njëjtë si "Prekja që rrëfen zanafilla", ku dora e Zotit i drejtohet baltës së njeriut. Në fund ishte vula e unazës së shenjtë të Zoradit. Ajo qe ende e njomë...





## KAPELJA ME QIRINJ

Në pjesën më të madhe të autoportreteve të Gojas është fytyra që shquhet  
Një palë sy te Cezane notojnë në kapriçon e penelatës  
Van Gog shikon nga një aureolë e errësires vorbulluese  
Rembrand duket sikur ka kaluar një krizë dhe tani merr frymë i lehtësuar nga piktura Verbimi i Sampsonit

Po pikërisht në këtë autoportret Goja qëndron larg pasqyrës  
Pozon në rrëmujën e studios së tij  
Duke iu drejtuar një kanavace që ndodhet disi e pjerrët prapa në një kavalet të gjatë.

Ai duket i buzëqeshur sikur e merr me mend  
Se sa do të argëtohem me kapelen e tij fantastike  
Një mbajtëse qirinsh rrethon strehëzën e saj  
Një shpikje kjo që e ndihmon të punojë gjatë natës

Ju do të pyesni veten me çudi  
Si mund të mbahet një llampadar i tillë mbi kokë  
Sikur të ishte një dhomë ngrënie ku hahet në këmbë ose një sallë koncertesh

Sapo e sheh këtë kapele nuk ke nevojë të lexosh  
Ndonjë biografi të Gojas, apo të mësosh përmendësh datat e jetës së tij.

Për të kuptuar Gojan mjafton të përfytyrosh  
Ndezjen e qirinjve një nga një, pastaj vendosjen  
E kapeles mbi kokë, gati për një natë pune.

Përfytyroni çastin kur shtang gruan me shpikjen e tij  
E qeshura e saj e bujshme si një tortë ditëlindjeje kur sheh tërë atë shkëlqim qirinsh

Përfytyroni si dridhet ai nëpër dhomat e shtepise  
Me të gjitha hijet që fluturojnë nëpër mure

Përfytyroni një udhëtar që ka humbur udhën dhe troket te porta e tij  
Në mesnatë në një vend kodrinor të Spanjës  
“Hyni brenda,” thotë ai, “ja, isha duke pikturuar veten”  
Qëndron në hyrje të portës dhe ngre lart penelin  
I ndriçuar nga qirinjtë që vezullojnë në kapelen e tij fantastike.

## DASHURI

Djali ishte ulur në vagonin e fundit të trenit  
Dhe herë pas here kthente kokën pas si me frikë  
Sikur priste me podurim dikë

Pas pak ajo u shfaq te xhami i derës së jashtme  
Dhe ai u ngrit, hapi derën dhe e la të hynte

Dhe ajo u fut brenda duke mbajtur në duar diçka të madhe të zezë  
Në formën e dallueshme të një violinqeli

Ajo i ngjante një engjëlli me ballë të lartë, sy të trishtë, flokë të gjatë të zinj  
Mbledhur pas qafës me një lidhëse të zezë

Dhe për shkak të kësaj  
Ai dukej pak si i zënë ngushtë në lumturinë e tij për ta parë drejt në sy  
Ndërsa ajo ishte thjeshtë aty, e gjallë, e përsosur, si një qenie me fytyrë të butë që luan në violinqel

Dhe arsyeja pse po e shkruaj këtë poezi në një zarf të madh dokumentesh  
Tani që ata kanë dalë nga treni bashkë

Është një hollësi delikate që nuk e harroj;  
Çasti kur ajo u kthye për të ngritur violinqelin e madh në mbajtësen e sipërme  
Dhe unë pashë djalin si ia kishte ngulur sytë çdo veprimi të saj

Dhe kjo më kujtoi mënyrën si janë pikturuar sytë e shenjtorëve  
Kur shikojne lart në qiell zotin në kohën që ai është duke bërë diçka të jashtëzakonshme  
Diçka që e dëshmon atë si zot.

## BILLY COLLINS

Dashuri  
e paqëllimshme

Përktheu: Roland Gjoza

## LITANI

Ti je buka dhe thika  
Gota e kristaltë dhe vera...  
-JACQUES CRICKILLON

Ti je buka dhe thika  
Gota e kristaltë dhe vera  
Ti je vesa në barin e mëngjesit  
Dhe rrota flakëruese e diellit  
Ti je përparësja e bardhë e bukëpjekësit  
Dhe zogjtë e kënetës që ngrihen në fluturim papritur

Por nuk je era në kopsht  
Kumbullat mbi banak  
Ose shtëpia e letrave të poetëve  
Sigurisht nuk je as ajri me aromë pishë  
Dhe nuk ekziston asnjë arsye që të jesh ajri me aromë pishë

Është e mundur që të jesh peshku nën urë  
Ndoshta dhe pëllumbi mbi kokën e gjeneralit  
Por nuk je kaq e afërt për të qenë  
Ara me lule misri në muzg

Dhe një vështrim i shpejtë në pasqyrë do të tregojë  
Se nuk je as çizmet në qoshe  
As varka që fle pranë ujërave të shtëpisë

Mund të kesh interes të dish  
Për gjuhën e pafundme të imazheve të botës  
Teksa unë jam tingulli i shiut mbi çati

Unë gjithashtu mund të jem ylli i këputur  
Gazeta e mbrëmjes që e merr era në një rrugicë  
Shporta me gështenja në tavolinën e kuzhinës

Mund të jem dhe hëna në pemë  
Dhe kupa e çajit të gruas së verbër  
Por mos u shqetëso, unë nuk jam buka dhe thika  
Ti je ende buka dhe thika  
Dhe do të jesh gjithmonë buka dhe thika  
Pa përmendur gotën e kristaltë dhe, në njëfarë mënyre, verën.

## MËNGJES

Pse ta vrasim mendjen për pjesën tjetër të ditës  
Për kanalet e pasdites  
Dhe rënien e papritur të mbrëmjes

Pastaj për natën me parfume mbytyës  
Yjet e saj me shumë cepa?

Më e mira që mund të bëjmë është kjo;  
Të flakim tej mbulesat e dritës  
Këmbët në dyshemenë e ftohtë  
Dhe ta bëjmë ekspresin të zhurmojë nëpër shtëpi

Një shpëlarje e shpejtë e fytyrës  
Një pëllëmbë me vitamina  
Dhe më pëlqyera zhurma e ekspresit nëpër shtëpi

Fjalor dhe atlas hapur mbi qilim  
Makina e shkrimit që pret çelësin e mendjes  
Një violinqel në radio.

Dhe, nëse është e nevojshme, hapja e dritareve  
Drurë pesëdhjetë, njëqind vjeçarë  
Atje jashtë  
Re të rënda mbi rrugë  
Dhe lëndina që avullon si kalë  
Në mëngjes herët.

## DASHURI E PAQËLLIMSHME

Sot në mëngjes po ecja në breg të liqenit  
Dhe rashë në dashuri me një harabelkë  
Pastaj gjatë ditës rashë në dashuri me një miushe  
Ndërsa macja dremiste nën tryezën e dhomës së ngrënies

Në hijet e një mbrëmje vjeshte  
Rashë në dashuri me një rrobaqepëse  
Që po hiqte tegela në një makinë qepëse  
Më vonë me një tas me lëng mishi  
Avulli i të cilit ngrihej si tymi i një beteje detare

Kjo është një lloj dashurie më e mirë, mendova  
Pa shpërblim, pa dhurata  
Pa fjalë të ndyra, pa dyshime  
Pa heshtje të gjata në telefon

Pastaj rashë në dashuri me një gështenjë  
Kapelen e xhazit në kokë dhe njëren dorë në timon

Pa epshe, pa përplasje dere  
Dashuri me një pemë portokalli  
Këmisha e bardhë e pastër, dushi i nxehtë në mbrëmje  
Autostrada që përshkon Floridën

Asnjë pritje, asnjë hutim, apo nervozizëm  
Vetëm një dhembje në zemër herë pas here

Për harabelkën që e kishte ngritur folenë  
Në një degë të përkulur mbi ujë  
Dhe për miushen e vdekur  
Që mbante ende kostumin kafe të çelur

Zemra ime është mbështetur  
Tek një trekëndësh në fushë  
Duke pritur shigjetën tjetër.

Pasi e ngrita miushen nga bishti  
E gjeta veten në lavamanin e banjës  
Duke parë me dashuri sapunin

Kaq i durueshëm dhe i tretshëm  
Kështu me sapunin e gjelbër të zbehtë  
Rashë në dashuri përsëri  
Dhe ndërsa ndieja si fërkohej dhe ledhatohej në duart e mia të lagura  
Përqafova aromën e tij të livandës dhe gurit.

## TRILL

Sonte hëna është si një biskotë e thatë  
Më pas një pjesë të saj  
Do ta përtypë qielli

Dhe një javë më vonë  
Sipas kalendarit  
Do të shfaqet  
Si një top futbollit i argjenditë

Dhe nëntë a dhjetë ditë më pas  
Do të më kujtojë një thua të hollë të shndritshëm

Përfundimisht  
Gjer në fund të muajit  
Them se  
Do të konsumohet për asgjë  
Dhe do të mbeten  
Në qiell  
Vetëm yjet

Më pas do të kem disa netë pa hënë  
Dhe unë vetëm fillikat  
Kjo është koha për të pushuar stilolapsi im nervoz.

## NËNTË KUAJ

Për ditëlindje  
Gruaja më dhuroi nëntë koka kuajsh  
Një fotografi fantazmë me nëntë katrorë mermeri të zi  
Nëntë katrorë në një shesh të madh  
Një gjë kaq e rëndë sa artisti  
Me vetëdije i ka varur  
Në një tra druri kundruall një muri guri të bardhë

Koka kuajsh në profil, koka të zbehta  
Sikur një blic i ka kapur duke ecur natën.

Koka të zbehta kuajsh  
Shikojnë skrivaninë time  
Me sy të zbrazët që duket sikur qajnë.

Gojë të hapura sikur janë ne grahmat e fundit  
Fotografi ka qëndruar mbi ta  
Në një dysheme kashte, makina e tij e zezë është parkuar  
pranë derës së stallës.

Nëntë kuaj të bardhë  
Ose një kalë që kamera e ka shumëfishuar me nëntë.

Kjo s'ka rëndësi, një trishtim i madh është mbledhur  
Në turirin e tyre të gjatë, të bardhë  
Larg, shumë larg nga kullota dhe sheqeri kubik.  
Fytyra e Shën Bartolomeut, fytyra e Shën Agnes.

Tufë e çuditshme kuajsh  
S'ngarkojnë më, s'tërheqin më asgjë  
Shikojnë këto veprime të përditshme të njeriut

Shikojnë këtë tryezë dhe këto gota  
Pecetat e mledhura role  
Darkat e dasmës së thikës dhe pirunit.

Shikojnë nga lart si perëndi me nëntë koka  
Dhe japin shenjën e pakënaqësisë  
Ose të një durimi të butë  
Që njeriu gabimet i quan suksese në jetën e tij

Shikojnë nga lart unazën  
E qirinjeve që dridhen në kokat e tyre të zbehta

Lërinë sytë tuaj të pikëlluar, kuaj  
Dhe vdekjet tuaja anonime

Bëhuni freri që na pengon të largohemi nga njëri-tjetri  
Bëhuni gjilpëra që na qep në barkun e çdo dite

Ndërsa largoheni me galop, thundrat ndezin natën.

### HARRESA

Në fillim është emri i autorit  
Që pasohet nga titulli e më pas nga subjekti  
Në fund është mbyllja e romanit me një tronditje të madhe  
Që e ke lexuar ndërkaq, por që të duket se nuk e ke lexuar  
dhe as ke dëgjuar ndonjëherë për të.

Dhe kujtimet që i kishe aq të qarta dikur  
Sikur tërhiqen një nga një në hemisferën e pasme të trurit  
Në një fshat të vogël ku nuk ka telefona.

Kohë më parë ke puthur emrat e nëntë muzave, tani iu thua  
lamtumirë  
Sheh ekuacionin kuadratik që mbyll çantën e tij  
Ndërsa mundohesh të mësosh përmendësh rendin e  
planeteve

Diçka tjetër gjithashtu po ikën, ndoshta një lule,  
Emri i një xhaxhai, kryeqyteti i Paraguajit

Sado që përpiqesh të kujtosh diçka  
Nuk të vjen kurrsesi në majë të gjuhës  
S'jep asnjë shenjë në ndonjë skutë të errët të shprekës tuaj

Ajo noton larg në një lumë mitologjik  
Emri i fillon me L, po tjetër gjë s'mbani mend.

Tani je duke ndjekur udhën drejt harresës, ku takoheni me  
shumë njerëz  
Që kanë harruar të notojnë dhe të ngasin biçikletën.

Mund të ndodhë që të ngrihesh natën  
Të kërkosh datën e një beteje në një libër mbi luftën  
Mund të ndodhë që hëna në dritare të dalë papritur  
Nga një poezi dashurie që dikur e dije përmendësh.

### DUKE HEQUR RROBAT E EMILY DICKINSONIT

Në fillim i hoqa shallin prej tyli  
Ia tërhoqa butësisht nga supet dhe ia shtriva  
Mbi shpinoren e një karrige druri

Dhe skufjen e saj  
Si harku e tërhoqa përpara

Fustani i saj i bardhë i gjatë dhe të tjera  
Çështje të ndërlikuara, si për shembull, ajo perla e mamasë  
Dhe kopsat poshtë shpinës  
Të shumta, të vockla, sa më dukej se aty do të mbeteshin  
përgjithmonë  
Para se gishtërinjtë e mi t'ia shkopsitnin fustanin plotësisht  
Si uji që hap notari  
Dhe rrëshqet aty pafundësisht

Natyrisht ju doni të dini  
Si qëndronte ajo në këmbë  
Pas dritares së hapur lart në dhomën e gjumit  
E shtangët, me sy gjysmë të mbyllur  
Duke shikuar kopshtin poshtë  
Dhe fustani i bardhë sikur i rridhte poshtë te këmbët  
Në dyshemenë e gjërë prej druri

Pastaj kompleksiteti i të brendshmeve të grave  
Në Amerikën e shekullit nëntëmbëdhjetë  
Dhe unë që s'hiqja dorë  
Nga puna si kërkues polar  
Nëpër kapëse e karfica, rripa e lidhëse  
Ndal këtu, ankorohu atje, nisni përsëri gjersa i preka korsënë  
Duke lundruar drejt ajsbergut të lakuriqësisë së saj

Vonë shkrova në një bllok  
Dhe kjo ishte si të hipje mbi një mjellmë nate  
Por sigurisht, nuk kam si t'ju tregoj gjithçka-  
Për atë mënyrën se si ajo i mbyllte sytë duke parë kopshtin  
Pastaj si u liruan nga karficat flokët e saj dhe u lëshuan  
poshtë  
Si e zunë fërgëllima të papritura  
Sa herë flisnim bashkë

Ajo që mund t'iu them është  
Se në Amherst ishte një qetësi e tmerrshme  
Atë të shtunë pasdite  
Agjë tjetër veç një karrocë që kaloi rastësisht  
Një mizë që ia bënte zu zu në kornizën e dritares

Kështu që unë e degjova si merrte frymë  
Ndërsa i zbërtheja pjesën e sipërme të korsesë  
Me grepa e kapëse mbërthyer

Dhe ndërsa degjova psherëtimën e saj të thellë kur më në  
fund u lirua plotësisht  
M'u kujtuan disa lexues që mirëfilli e kuptuan  
Se shpresa është diçka prej puplash  
Dhe arsyeja është një dërrasë që kërcet  
Se jeta është një armë e mbushur  
Që të shikon drejtpërdrejt me një sy të verdhë.

### DITË BORE

Sot na zgjoi revolucioni i borës  
Flamuri i bardhë valëvitet mbi gjithçka,  
Peizazhi u fsheh,  
S'sheh dhe një mi për të dalluar sado pak zbrazëtinë  
Përtej dritareve

Ndërtesat qeveritare u fundosën  
Shkollat dhe bibliotekat u varrosën, posta s'duket  
Nën breshërinë pa zhurmë,  
Linjat e trenave u bllokuan me një butësi puple,  
Bie bota nën këtë rënie pa bujë.

Pas pak do të vesh çizmet  
Do dal jashtë me ndjesinë se do të eci në ujë,  
Dhe qeni do kalojë i pari dhe do rrëshqasë,  
Dhe unë do tund një degë të ngarkuar me pllaza bore  
Që do na bëjnë të dyve një dush të ftohtë.

Por në këto çaste jam një i burgosur në shtëpi,  
Një simpatizues i borës anarkiste.  
Do ziej një tenxhere me çaj  
Dhe do dëgjoj radion plastike mbi banak,  
I lumtur sa kushdo tjetër për të dëgjuar lajmet

...Se shkolla Kiddie Corner është mbyllur,  
Shkolla Ding-Dong, gjithashtu.  
Të gjithë shkollat e fëmijëve, mbyllur,  
Kopshti Hi-Ho, mbyllur,  
Së bashku me - disa do të jenë të kënaqur të dëgjojnë -

Shkolla Toadstool, shkolla fillore,  
Çerdhja e Harabelave të Vegjël,  
Little Stars parashkollor, shkolla Ditore Peas-and-Carrots  
Qendra e fëmijëve Tom Thumb, te gjitha të mbyllura,  
dhe — ketu do te duartrokasin — e mbyllur dhe shkolla Play  
Peanuts.

Pra, këtu fshihen fëmijët gjatë gjithë ditës,  
Këto janë foletë ku ata shkruajnë dhe vizatojnë,  
Ku veshin xhupat e tyre të ndritshëm, imcak,  
Të gjithë vrapojnë, ngjiten dhe rrëshqasin,  
Të gjithë, përveç vajzave të pakta që pëshpërisin pranë  
gardhit.

Unë rri dhe degjoj  
Në heshtjen madhështore të borës,  
Çfarë po komplotojnë ato tre vajza,  
Çfarë trazire po ndodh  
Cila mbretëreshë e vogël do të rrëzohet.



Më 1935, shkrimtari Isaac Bashevis Singer braktisi të shoqen dhe të birin e vogël në Varshavë, erdhi në Nju-Jork dhe rrjedhimisht, u martua. Njëzet vjet më vonë i biri lundroi nga Izraeli për ta parë. Nuk ishte prej dashurisë, shkruan Israel Zamir-i, por kureshtja dhe nevoja për të “mbyllur rrethin”.

“Udhëtim drejt babait tim”, një libër i sikletshëm, zbulues dhe ndonjëherë magjepsës, nuk mbyll asgjë. Në vend të kësaj, vjen rrotull si një kërcim ndjellës, që ka zgjatur për tri dekadat e ardhshme deri në vdekjen e Singer-it më 1991. Ajo që është ndjellës është inati, dhembja dhe magjepsja e të birit me magjistarin plak bishtnues, të cilin as nuk mund ta falë e as nuk mund të heqë dorë prej tij.

Anija e Zamir-it arrin në Nju-Jork në një mesnatë dimri. Katërmëdhjetë orë me vonesë, ai nuk është i sigurt se ç’pamje ka i ati dhe nuk sheh askënd që mund t’i ngjajë. Më në fund, vëren një burrë me flokë si të kuq, duke pritur i pasigurt. “Mos ndoshta jeni ju z. Singer?” - e pyet burri i ri. “Ndoshta”. “A ka mundësi që ju të jeni im atë?” “Ka mundësi”, - i përgjigjet tjetri dhe shton:

“Çdo gjë është e mundur. Nuk mund ta dish kurrë nëse lojërat e tua prej kohërave të shkuara kanë prodhuar një djalë i cili do të shfaqet papritur prej anës tjetër të oqeanit dhe të kërkojë pjesën e tij të trashëgimisë.”

I biri largohet i inatosur: njëzet vjet braktisje të duruara me hidhërim kanë thirrur pikërisht figurën që ai kishte imagjinuar, pikërisht atë lloj shfaqjeje sardonike që thërrasin inati, xhelozia, epshi apo hakmarrja në një rrëfim të Singer-it, vetëm se Singer-i do t’i kishte shtuar një kthesë tjetër. Babai i vërtetë, i zbehtë, modest, jokomunikues, po e pret jashtë dhe atë e bir marrin një taksì, thuhet në heshtje, për të apartamenti i Singer-it në Upper West Side.

“Udhëtim...” regjistron atë udhëtim në heshtje në taksì. Vazhdon të regjistrojë 35 vite takimesh, shoqërimesh sporadike dhe bashkëpunime të konsiderueshme – Zamir-i përktheu një pjesë të veprave të të atit nga jidishi në hebraisht – dhe një miqësi në tentativë. Por i biri nuk u afrua dot kurrë. Si mund të afrosh me një shkrimtar si Singer-i? Bëhesh një prej personazheve të tij.

Komunist në atë kohë, anëtar i një kibuzi të majtë, një izraelit i mprehtë e atletik, Zamir-i – i cili kur ishte adoleshent grisi disa letra që i dërgoi Singer-i – është çdo gjë që i ati i tij mistik e i zbehtë nuk është. Një “Luftmensch” – intelektual ajror – e quante me patronizim. Por, gjithsesi, ashtu si me atë mbërritje dimri, kujtimet e Zamir-it kthehen në rrëfime të Singer-it.

Vizita e parë iu afrua shndërrimit në një braktisje të dytë. Zamir-i u zgjua në apartament mëngjesin tjetër “me një boshllëk ndjesish”. Sheh babain që del nga banja, me këmbët e holla të dala nga rrobëdhoma e vjetër kafe dhe ulet për të shkruar “pa asnjë fjalë”. Singer-i është i kujdesshëm, sikur i druhej ndonjë kërkese për kohë, para apo histori. Nuk i kërkon kurrë falje për arratisjen e rimartësën, dhe Zamir-i është tepër krenar për t’ia kërkuar. Pa para në xhep, Zamir-i ka mbetur trokë, përveç ndonjë dollari rastësor që mund t’i jepte i ati.

Përgjatë tri dekadave të ardhshme ka vizita nga Izraeli në Nju-Jork, ecejake, biseda dhe bashkëpunime për përkthime. “Kisha arritur ‘të ndërtoja’ një baba për veten time”, - shkruan Zamir-i; por herë pas here,

“Udhëtim drejt babait tim, Isaac Bashevis Singer”, nga Israel Zamir

## TË NDJEKËSH ATË MAGJISTAR PLAK BISHTNUES: kujtimet e birit të nobelistit Isaac Bashevis Singer, një libër i sikletshëm dhe ndonjëherë magjepsës

Nga Richard Eder

mes anekdotave dhe kujtimeve, e përmend sërish atë dollar rastësor. Babai i vë në dukje vite më vonë se, në fund të fundit, ai kishte paguar për udhëtimin. Por me monedhën izraelite të bllokuar, i biri replikon. E emëroi si përkthyesin e tij, thotë Singer-i. Për të kursyer para, thotë Zamir-i. Bleu krevat dhe dyshek ku ai të flinte, proteston Singer-i. Atë e bir zbehen; e merr në dorë fabulisti Isaac Bashevis Singer.

Duke folur për veten, Zamir-i mund të jetë nervoz dhe ndonjëherë i ngathët. Nga ana tjetër, portreti i tij anekdotal i Singer-it është i çmuar, komik, me një majë alarmim. Ka një pasazh të tijin si djalë i ri duke qëndruar jorehat nën hijen e vëllait më të madh I. J. Singer, autor i “The Brothers Ashkenazi” dhe një kronist i jetës geto në një mënyrë realiste, në të kundërt të misticizmit të hidhur e erotik të Singer-it.

I shoqërueshëm dhe shumë më i njohur, I.J. ishte patroni dhe mbrojtësi i përkushtuar i Isaac-ut; ai e solli në Nju-Jork dhe i gjeti punë. I tregonte Isaac-ut dorëshkrimet e tij – të gjitha këto vijnë nga e veja e I. J., të cilën Zamir-i e takon rastësisht – ndërkohë që ky i fundit fshehu të tijat. Ai fshehu dhe ndonjë mëri që mund të kishte ndier, por në një letër Isaac-u pohon se niveli i shkrimit i I. J. kishte rënë; dhe sa për vete: “Heshtja ime është më e mirë.”

Ka pasazhe të Isaac-ut në lagjen e tij në Upper Broadway, duke ushqyer pëllumbat që fluturonin aty poshtë. Një polic i thotë të ndalojë; ditën tjetër, polici, duke i kërkuar falje, i zgjat një libër për ta nënshkruar. “Nëse një polic nga Nju-Jorku i kërkon një shkrimtari jidish të nënshkruajë librin e tij, ka ende shpresë”, - thotë Singer-i.

Vite më vonë, ama, gjatë luftës së vitit 1967 në Izrael, Singer-i dhe Zamir-i u bashkuan në një radhë duke pritur që t’i dhurojnë para United Jewish Appeal-it. Disa qanë; nuk ishte menjëherë e qartë nëse Izraeli do të mbijetonte. Bota nuk mund të përballojë një Aushvitz tjetër, këmbënguli një rabin që priste në radhë. Zamir-i shkruan: “Babai im, duke më tërhequr mëngën, pëshpëriti: ‘Bota mund të përballojë çdo gjë.’”

Singer-i nuk mund t’u rezistonte grave dhe ishte vetë i pazezistueshëm. McCalls-i e quajti njëherë një prej 10 burrave më seksi në Amerikë. Nuk ishin librat e tij, por sytë e mëdhenj blu në një fytyrë të zbehtë rrumbullake dhe interesi i kufizuar për të dëgjuar historitë e grave. Lexueset e telefononin; nëse tingëllonin interesante, ai do të organizonte një bisedë të gjatë në restorantin e Steinberg-ut, vendi i tij intim kosher në Upper Broadway. Alma, bashkëshortja e tij e dytë, shfaqte tolerancë

të konsiderueshme, megjithëse ndërhynte ndonjëherë kur gjërat dukeshin se do të shkonim shumë larg. Shkuan vërtet larg, ama. “Babai im e konsideronte krevatin si kulmin e bisedës, veç se horizontalisht”, - shkruan Zamir-i dhe vijon duke cituar një bisedë mesdite:

“Filozofët në të shkuarën u përpoqën të neutralizonin ndjenjat dhe epshin, - mendoi Singer-i, - dhe t’i tokëzonin mendimet e tyre në logjikë, duke hamendësuar se çdo gjë shkon përmes trurit tonë. Hiqe epshin tonë dhe duket si gjethe lakre. U besoj ndjenjave që kthehen në epsh. Besoj se kur një burrë dhe një grua puthen dhe deklarojnë se nuk mund të jetojnë pa njëri-tjetrin, është fillimi i një çështjeje shpirtërore, jo thjesht materiale. Bota jonë është kaq misterioze. Del nga shtëpia, takon një grua në Broadway dhe jeta jote ndryshon. Meqë ra fjala, sa është ora?”

“Një e gjysmë”.

“Duhet të shkoj. Një grua më telefonoi nga Bronx-i dhe u betua me ç’kishte të shenjtë se, në një kafene në Jerome Avenue, pa Adolf Hitlerin”.

Në vitet e tij të fundit, duke u bërë më i dobët, Singer-i u bë më i zymtë. Fliste me aprovim për ngritjen e judaizmit strikt ortodoks. Pendimi, thotë, “nuk është një rebelim kundër kënaqësive të jetës, por një rebelim kundër dëshpërimit” – një mendim, ironinë e të cilit mund ta kishte vlerësuar apo jo, që është thënë në thuasje të njëjtat fjalë nga papa Gjon Pali i Dytë.

Ai besonte në Zot, por në mënyrë akuzuese. Gjatë Holokaustit, i thotë Zamir-it, Zoti “u ul aty në Parajsën e tij të Shtatë, i rrethuar nga engjëj që i këndonim me zë të lartë himne lavdie. Hebrajët thërrisnin nga furrat, krematoriumi, por ai nuk i dëgjonte. Ndërkohë që merrte lavde, ne morëm dhomat e gazit”.

Ka diçka të njohur te kjo. Tingëllon, në fakt, si notat binjake të ftohjes së inatosur, dhe identifikimit të pashpresë që përshkojnë këtë memuar. Zamir-i ishte për të atin pakashumë siç Isaac Bashevis Singer ishte për Zotin, i cili kur bëri burrin, siç kundërshtoi njëherë Singer-i, “nuk përdori materialet më të mira”.

LA Times

Përktheu Enxhi Hudhri



Në poezinë “Realiteti”, poetja polake Wislawa Szymborska (Wislawa Szymborska), fituese e çmimit Nobel për letërsinë në vitin 1996, e vendos lexuesin në kufi mes vetëdijes dhe nënvetëdijes, të ndërgjegjshmes dhe të pandërgjegjshmes, e natyrisht, realitetit dhe ëndrrës. Kjo poezi ndërtohet pikërisht mbi bazën e kontrastit të fortë mes këtyre dy të fundit, duke përcjellë idenë e misterjoses dhe ndjesinë e frikës dhe të ankthit që ngërthen kjo botë reale.

*Realiteti s'ka si me t'u përvjedhë,  
Siç përvjedhen andrrat.  
Asnjë shushurimë, asnjë tringëllimë  
Atë s'mund me e trembë,  
Asnjë brimë, asnjë buçimë  
Prej tij s'kanë me shkepë.*

Përplasja mes ëndrrës dhe reales figuron që në strofën e parë. Në qoftë se njeriu e ka mundësinë (dhe nëse mund të themi, fatin apo luksin) t'i shpëtojë një ëndrre, qoftë kjo e bukur apo e keqe, me realitetin ndodh ndryshe. Sado që mund ta dëshirojë njeriu, shpëtimi nga realiteti nuk i vjen dot kur është e nevojshme. Në të vërtetë, ky shpëtim nuk është fare i mundur, dhe as përpjekja më e vogël, si e jashtme, ashtu edhe e brendshme, nuk e largon dot realen. *Realiteti s'ka si me t'u përvjedhë.* Nëse mjafton një ngacmim i jashtëm (si p.sh. një zhurmë ose drita) apo një sens i brendshëm i frikës dhe i vetëdijes gjysmë të fjetur e gjysmë të zgjuar për ta shpëtuar njeriun nga makthi ëndërrimtar, prej makthit real duket se nuk e shpëton gjë (*Prej tij s'kanë me shkepë*).

*Të turbullta e shumëkuptimëshe  
Janë imazhet në gjumë,  
Mundesh me i shkoqit ato  
Kështu e ashtu.  
Realiteti don me thanë – realitet,  
Dhe bash këtu ma ke enigmën.*

*Për andrrallat ka çilësa.  
Realiteti hapet vetë,  
Dhe dot s'ia del me e mbyllë.*

Poetja e përball lexuesin me një paradoks, me një propozim në pamje të parë të çuditshëm, por që mbart në thelb një dilemë njerëzore; një pohim me shumë pyetje përbrenda. Ëndrrat, këto forma alternative të nënvetëdijes sonë, na shfaqen të turbullta e shumëkuptimëshe, plot paqartësi dhe ambiguitete. Megjithatë, po t'u hyjmë thellë këtyre copëzave të së pandërgjegjshmes së shtypur, të veshura e të maskuara me një vel fantazie dhe imagjinate, mund t'ua shkoqisim këtë domethënie të fshehtë, t'ua heqim maskën që na mbron nga sekretet e nëntëshme të ëndërrimeve. *Për andrrat ka çilësa* shkruan Szymborska, dhe për më tepër që *andrrat s'kishin mujtë me ekzistue pa ne*, duke na mundësuar që t'u ngrihem kundër këtyre “andrrallave”. E tërë kjo vetëm në sajë të të kërkuarit thellë brenda vetes; brenda reales sonë të brendshme.

Nga ana tjetër, ndonëse realitetin arrijmë ta përkapim përmes secilës prej shqisave tona, duket se ai mbetet një enigmë për mendjen tonë. Njeriu, sidomos ai i kohëve moderne, e gjen veten në mes të kontradiktave, të paradokseve, të kontrasteve. Nuk i shpëton dot debateve dhe konflikteve të jetës reale, qofshin ato kolektive apo personale, politike apo kulturore. Në një shoqëri kinse “moderne”, një shoqëri të dehumanizuar ku objektet e pajeta dhe ideologjitë e paqena kanë më shumë pushtet sesa qenia njerëzore dhe ku paqja e mirëqenia zëvendësohen me terrorin dhe fatalitetin, realiteti përfundon duke mos qenë më shumë se një pikëpyetje e madhe, e ndërtuar mbi shumë attribute dhe aksioma të cilat jemi mësuar t'i marrim për të mirëqena dhe mbi saktësinë e të cilave

Poezia “Realiteti”, e poetes polake Wislawa Szymborska, fituese e çmimit Nobel për letërsinë në vitin 1996

## Realiteti “i çmendun” nën optikën shimborskiane

Nga Noel Boci

na kanë mësuar të mos dyshojmë kurrë. Një pikëpyetje kjo së cilës nuk i japim dot përgjigjeje.

*Nuk janë andrrat të çmenduna,  
I çmendun ashtë realiteti,  
Ma s'paku kokfortësia,  
Me të cilën ai mbahet  
Pas dromit të ngjarjeve.*

Ëndrra në vetvete, në sajë të “nonsensit” të vet alla Lewis Carroll, shpesh na krijojnë vërtet idenë e së çmendurës, të palogjikshmes dhe absurdes. Kushedi sa herë mund të jemi zgjuar e të kemi thënë me vete: “Ç'ishte ajo ëndërr e marrë?”. Gjasat janë që do e kemi harruar ëndrrën. Megjithatë, kjo “pa-ose jokuptimësi” ngërthen në vetvete një shumëkuptimësi jo dhe aq të paiterpretueshme sa e mendojmë ne. Jo më kot Szymborska konstaton se *për andrrat ka çilësa*.

Çmenduria e vërtetë qëndron pikërisht në botën reale; në realitetin e trishtë dhe të zymtë; në atë realitet ku njerëzit, duke pasur mundësinë të jetojnë në paqe, të mirëkuptojnë dhe të respektojnë “tjetrin”, të mbushin kohën me art, letërsi, dashuri, etj., ata zgjedhin të urrejnë, të shkatërrojnë, të dhunojnë dhe të përdhunojnë, të shkaktajnë luftëra dhe gjenocide. Kjo është vërtetë çmenduria për poeten: *tmerri i historisë së qenies njerëzore*, një histori kjo që pikon

gjak e lot, e shkak i së cilës është vetë *homo sapiens*-i, krijesa gjasme “e zgjuar”, që zgjuarsinë dhe imagjinatën e vet e përdor për të përdhosur e për të shkelur çdo gjurmë sado të vogël bukurie e pafajësie.

Për të mos lënë pas dhe faktin që gjurmët e ëndrrës, herë sapo zgjohemi e herë pas ca kohe, në më të shumtën e rasteve, vjen momenti e zhduken. Edhe nëse nuk zhduken, ato mbesin te ne thjesht si imazhe, si figura që nuk na shqetësojnë dot më. Kurse vula e realitetit, kjo damkë turpi që herët a vonë shenjon çdo qenie të caktuar njerëzore, zor se zhduket ndonjëherë. Ne mund ta fshehim atë, ama ajo vazhdon të qëndrojë aty dhe ne nuk shpëtojmë dot prej saj. Ndaj dhe poetja shkruan:

*N'andrra asht ende gjallë  
I sapovdekuni ynë i mbramë,  
Gëzon shëndet të plotë  
Dhe një rini t'gastartë.  
Realiteti vë para nesh  
Korpin e tij të vdekun.  
Realiteti nuk ban asnjë hap mbrapa.*

*Andrrat janë efemere,  
Kujtesa ato i fshin me lehtësi.  
Realitetin dot s'e harron.  
Ai është i pakapërcyeshëm.  
Na peshon mbi qafë,  
Na shtyp zemrën,  
Na bie ndër kambë.*

Bota do të vazhdojë të ecë me ritmin e saj, në valën e pambarimtë të çmendurisë e të marrëzisë, në një rrëmujë të përhershme. Ajo të përball me terrorin e vërtetë pa iu dridhur çerpiku: terrore të tilla janë më se normale për të. Realiteti nuk pret që ti ta pranosh dhe nuk pretendon që të të përshtatet. Ai vetëm të vë para dilemës së pazgjidhshme: “m'u përshtat ose së shpejti do të jesh ti *korpi i vdekun!*”

Realiteti na rri sipër si vdekja, veshur me një mantel të zi e me kosë në dorë. Realiteti kthehet në diktatorin e plotfuqishëm që merr me vete çfarëdo që t'i dalë përpara, aq sa lind pyetja paradoksale: është vallë vërtet njeriu ai që e krijojnë realitetin që e rrethon, apo është realiteti ai që e kushtëzon njeriun? Apo mos vallë ekziston një grup personash të fuqishëm që ngrihen mbi njerëzit e që krijojnë vetë një realitet aq të shëmtuar e aq të pashpresë sa njerëzit nuk kanë asnjë rrugë shpëtimi përveçse t'u nënshtrohen urdhrave të tyre? Sido që të jetë e vërteta, realiteti kthehet në një sëmundje që kap këdo e nuk lëshon askënd:

*Asht e pamundun me ikë prej tij,  
Ai ka me këndë gjithkund me ju.  
Në të gjitha rrugët e hetimeve tona –  
Nuk ka ndonjë stacion të tillë –  
Ku mos me na pritë ai.<sup>1</sup>*

Duket se ëndrra mijëravjeçare e njerëzimit për t'i shpëtuar realitetit me çfarëdo mënyre nuk është më shumë se një iluzion i rremë, një zhgënjendërr, një klithmë e mbytur në fyt pa pasur guximin të dalë, një lot i gëlltitur që të djeg sytë e t'i vesh me një cipë të turbullt që vetëm sa e shëmtton realitetin, pamjes së të cilit as i verbri nuk i shpëton dot.

Njeriut s'i ngelet asgjë tjetër, veçse ta pranohet realitetin siç është e të mundohet të ruajë e të fshehë mirë të paktën atë pak vetvete autentike thelbësore që realiteti nuk ia sheh e nuk ia shndërron dot.

<sup>1</sup> Poezia e përkthyer prej origjinalit nga: Agron Tufa



E shtunë, 23.11.2024, ora 11:00  
Biblioteka "Marin Barleti", Shkodër



# DURIM TAÇI

Përuror romanin:

# LAKIMI



Moderon **Enza Rripaj**